



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, siç jeni në dijeni, po fillojmë mbledhjen e programuar më datë 2 korrik 2020. Sot në rendin e ditës kemi 12 çështje, për të cilat jeni njohur. Nëse keni ndonjë gjë me rendin e ditës përpara se të fillojmë me shqyrtimin e secilës prej çështjeve.

Illir Toska: Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, siç ju ka bërë me dije përmes e-maileve që ju janë dërguar, kërkon që të shtojë në rendin e ditës, në pikën 2, si nënçështje, 2 projektvendime lidhur me hapjen rishtazi të dy pozicioneve të lira në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin edhe Krimin e Organizuar, pra në shkallën e parë dhe të apelit (për secilën nga një pozicion). Po kështu, të shtohet në rendin e ditës edhe si pikë e fundit të rendit të ditës çështja për caktim gjyqtari në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin, janë të paktën në dy raste 2 çështje urgjente që do duhet të caktojmë gjyqtarë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Ilir!

Atëherë, jemi dakord që të shtojmë çështjet e propozuara nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në rendin e ditës, pra gjithsej 3 çështje.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, përfshihen në rendin e ditës 3 çështjet e propozuara.

Atëherë, pa vonesë po kalojmë në shqyrtimin e çështjes së parë, e cila ka të bëjë me shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”. Lidhur me relatimin e kësaj çështjeje fjalën ia jap zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, KZHK ka propozuar projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, konkretisht për vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188.

Lidhur me këtë projektvendim, ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues sa i përket arsyeve dhe motiveve që kanë shtyrë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për

propozimin e këtij projektvendimi. Shkurtimisht po përpiqem t'i them edhe verbalisht këto.

Sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ushtron edhe funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

Funksioni kushtetues si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që lidhet me zhvillimin e karrierës gjyqësore, gjen rregullim të mëtejshëm në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 86, shkronja “ç”, ndërkohë që në shkronjën “ë” të kësaj dispozite, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Më tej, përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), pikërisht në nenin 48, ndërkohë që në pikën 7 të kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe për ata që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”.

Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për kandidatët që kanë kandiduar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176,

nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, afati i kandidimit për të cilët ka përfunduar më datë 15.06.2020.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart, “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, nëpërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të sipërpërmendura, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Referuar kandidaturave të paraqitura për secilin nga pozicionet e lira të sipërpërmendura, në total 21 kandidatë, rezulton se 4 prej tyre kanë kandiduar edhe për pozicione të lira në proces shqyrtimi për në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për një situatë të tillë, në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të aktit nënligjor të sipërpërmendur, është parashikuar se “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Në kuptim dhe zbatim të këtij rregulli, për katër kandidatët që kanë kandiduar për disa pozicione të lira në proces shqyrtimi, sa i përket kritereve të pasurisë dhe figurës, që janë të njëjtë për çdo lloj kandidimi, procedura e verifikimit që është në proces e sipër në lidhje me to, do të duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për kandidimin e këtyre katër kandidatëve për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

Sa i përket katër kandidatëve që kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e shpallura më datë 26.02.2020 dhe 28.05.2020, të dhënat për kandidimet e tyre janë si vijon:

Kandidati z. {...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për dy pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura me Vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;

Kandidatja znj.{...} - ka kandiduar në total për 5 pozicione të lira që janë në proces - për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020;

Kandidati z.{...} - ka kandiduar në total për 6 pozicione të lira që janë në proces - për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, si dhe për tre pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura respektivisht me Vendimet nr. 176, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;

Kandidatja znj.{...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, si dhe për tre pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020.

Në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi diskutoi mbi kuptimin dhe zbatimin e kufizimit të së drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, vlerësoi se ky kufizim duhet të shtrihet për kandidimet brenda një raundi, pra për procedurat e ngritjes në detyrë të shpallura brenda një periudhe 3-mujore, referuar fjalisë së parë të pikës 2, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, interpretim ky i bërë mbi logjikën se pamundësia e Këshillit për të përfunduar procedurat e ngritjes në detyrë të një raundi brenda 3 muajve, siç përcakton fjalia e dytë e kësaj pike të ligjit, nuk duhet të përbënte shkak për kufizimet e të drejtës së kandidimit për procedurat e ngritjes në detyrë që shpallehin pas kalimit të këtij afati.

Nisur nga kjo, në njoftimet publike të datës 29.05.2020, për shpalljen e hapjes së procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit sipas vendimeve të Këshillit të datës 28.05.2020, çdo të interesuari i është kërkuar që të mbajë në vëmendje se:

1. Në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit (të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrative) mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret e

ligjës, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar më parë në procedura të tjera për ngritjen në detyrë, procedura këto që nuk janë finalizuar ende.

2. Çdo kandidat, në respektim të kufizimit të përcaktuar në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të kandidojë për ngritjen në detyrë për jo më shumë se tre pozicione të lira, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020, qofshin ato edhe në të njëjtën gjykatë.

Ndërkohë, gjatë diskutimeve me Misionin EURALIUS në kuadër të përgatitjes së projekt-akteve të ndryshme në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore, nga ekspertë të tij u shprehën opinione jo të njëjta me qëndrimin e Këshillit në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, në lidhje me shtrirjen e kufizimit të së drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Për këtë shkak, në kushtet kur Këshilli po përballej për herë të parë me shtrirjen e kufizimit të së drejtës së kandidimit sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, duke vlerësuar se zbatimi i këtij kufizimi do të përbënte një standard të përhershëm në veprimtarinë e tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 24.06.2020, vlerësoi t’i kërkojë Misionit EURALIUS një opinion ligjor në lidhje me këtë.

Konkretisht, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka parashtruar Misionit EURALIUS kërkesën si më poshtë:

“Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikërisht në funksion të interpretimit dhe zbatimit të drejtë të kufizimit të së drejtës së kandidimit për ngritjen në detyrë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira, sipas fjalisë së parë të pikës 6, të nenit 48, të këtij ligji, kërkojmë një opinion ligjor në lidhje me shtrirjen e këtij kufizimi.

Në pikën 2, të nenit 48, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës”.

Në situatën që pozicionet nuk arrihet të plotësohen brenda tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës, pra kur procedurat përkatëse për ngritjen në detyrë për secilin nga ato pozicione nuk përmbyllen në këtë afat, për kandidatin që ka kandiduar për jo më shumë se tre nga këto pozicione, a shtrihet i njëjti kufizim nëse ai kandidon në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicione të tjera të lira që mund të shpallen pas kalimit të këtij afati?

Nëse ky kufizim shtrihet edhe në një situatë të tillë, atëherë kjo gjë nënkupton pamundësinë e kandidatit për të kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë të shpallura rishtazi? Apo kandidati mund të kandidojë në këto procedura, por në këtë rast do të duhet të rikonsiderojë kandidimet në tërësi në kuptimin që ato të mos jenë për më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira?

Cili është interesi publik i vendosjes së një kufizimi të tillë?”

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Misioni EURALIUS, më datë 29.06.2020, dërgoi opinionin ligjor si më poshtë:

“Analiza Ligjore Sipas Nenit 48 (6) të Ligjit për Statusin: “Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës”.

Ky nen parashikon qartë se kandidati nuk mund të aplikojë për më shumë se tre vende të lira gjatë procedurës së ngritjes në detyrë. Megjithatë ligji nuk parashikon një përkufizim se çfarë duhet të konsiderohet një “procedure ngritjeje në detyrë” e cila rrjedh nga interpretimi sistematik i ligjit.

Ligji për Statusin nuk përcakton numrin e vendeve të lira të cilat duhet të përfshihen në procedurën e ngritjes në detyrë. Rrjedhimisht, në varësi të gjendjes aktuale të vendeve të lira në sistemin gjyqësor, Këshilli mund të nisë në një kohë (në një raund) një procedurë për ngritjen në detyrë e cila përfshin vetëm një vend të lirë, ose një procedurë ngritjeje në detyrë e cila përfshin më shumë vende të lira, për shembull 5 vende të lira, të ndryshme në të njëjtën kohë (i njëjti raund) në një ose në gjykata të ndryshme.

Gjithashtu, Ligji për Statusin nuk parashikon një periudhë kohe të caktuar brenda së cilës Këshilli duhet të nisë një procedurë ngritjeje në detyrë. Neni 48 (2) i Ligjit për

Statusin parashikon se në rastet kur ka shumë vende të lira të cilat nuk janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, procedura e ngritjes në detyrë organizohet të paktën një herë në tre muaj. Rrjedhimisht, në varësi të situatës, Këshilli mund të shpallë procedura të ngritjes në detyrë (për një ose më shumë vende të lira), çdo ditë, çdo javë, çdo muaj por në çdo rast, të paktën një herë në çdo tre muaj.

Duket sikur fleksibiliteti që Ligji i jep Këshillit për të nisur procedura të ngritjes në detyrë, reflekton konceptin se është e pamundur të planifikosh me përpikëri, paraprakisht, çdo nevojë të sistemit gjyqësor në lidhje me plotësimin e vendeve të lira, sepse këto nevoja mund të lindin nga një gamë e gjerë situatash.

Pyetja që ngrihet është nëse kufizimi i nenit 48 (6) i Ligjit për Statusin zbatohet për “ngritjen në detyrë” në tërësi, pra raunde të ndryshme të ngritjes në detyrë, apo zbatohet vetëm për secilin raund të procedurave për vendet e lira të nisura nga Këshilli në një shpallje? Përgjigja për këtë pyetje mund të gjendet nëpërmjet një interpretimi fjalë për fjalë dhe sistematik të Nenit 48 (6) të Ligjit për Statusin.

Së pari, kur vendos kufizimin, Neni 48 (6) i Ligjit për Statusin i referohet fjalë për fjalë “procedurës së ngritjes në detyrë” në përgjithësi, kurse Neni 48 (2), i Ligjit për Statusin përdor termin “procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë”. Kjo do të thotë se kur Këshilli shpall thirrjet për aplikime për ngritje në detyrë (me fjalë të tjera – raundin me procedurat e ngritjes në detyrë për çdo vend të lirë) kandidati mund të aplikojë deri në tre vende të lira (ose vende të cilat priten të bëhen të lira).

Së dyti, ligji e përcakton qartë se kandidati nuk mund të aplikojë për më shumë se tre vende të lira (në versionin shqip të ligjit, është përdorur literalisht termi “kandidon”). Një kandidat është në procedurë kandidimi për sa kohë kandidimi i tij është ende në proces, që do të thotë nuk është përjashtuar apo nga i cili nuk është hequr dorë.

Për pasojë, interpretimi sistematik i Nenit 48 (6) i Ligjit për Statusin është që kandidati nuk mund të ketë në të njëjtën kohë, të hapura ose në proces më shumë se tre procedura ngritjeje në detyrë (ose të kandidojë), me fjalë të tjera, gjatë procedurës së ngritjes në detyrë në tërësi, pavarësisht nëse këto kandidatura/aplikime janë paraqitur në të njëjtin raund ose në raunde të ndryshme të procedurës së ngritjes në detyrë.

Kuptime apo interpretime të tjera të Nenit 48 (6) të Ligjit për Statusin jo vetëm do të shkonin kundër kuptimit literal të parashikimit (i cili nuk flet për tre vende të lira “në

një thirrje për aplikimet” ose “në një raund”) por gjithashtu do të krijonte mundësinë e aplikimeve në tre vende të lira çdo herë që Këshilli do të shpallte thirrjen për aplikim për një ngritje në detyrë. Prandaj, nëse Këshilli do të shpallte vendet e lira, për shembull, çdo muaj, një kandidat mund të aplikojë në nëntë vende të lira të ndryshme të shpallura brenda një periudhe tremujore.

Vërejtje krahasuese:

Ndonjëherë analiza e kuptimit dhe zbatimit të parashikimeve ligjore në vende të tjera me parashikime ligjore shumë të ngjashme mund të rezultojë të jetë e dobishme për zbatimin e sistemit ligjor vendas.

Thënë këtë, duhet të theksohet se sistemi i ngritjes në detyrë i gjyqtarëve në vende evropiane nuk është i njësuar dhe vende të ndryshme të Bashkimit Evropian zgjedhin modele të ndryshme për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Ndaj, shembujt nga shumica e vendeve evropiane nuk do të ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Më konkretisht, në shumicën e vendeve evropiane (pavarësisht nëse kanë një këshill gjyqësor ose jo) gjyqtarët mund të aplikojnë në shumë pozicione në të njëjtën kohë. Për shembull, mund të përmendim vende si Austria, Bullgaria, Kroacia, Franca, Gjermania, Holanda ose Portugalia.

Megjithatë, disa vende parashikojnë edhe kufizime të ndryshme. Për shembull, në Poloni një gjyqtar i cili ka aplikuar për një vend të lirë në një gjykatë të zakonshme nuk lejohet të aplikojë në një vend të lirë në gjykata të tjera (pra në gjykatat administrative ose Gjykatën e Lartë) dhe e anasjella, derisa të përmbillet procedura (ose derisa ai të tërhiqet nga aplikimi). Gjithashtu, në Rumani ekziston një kufizim për të aplikuar vetëm në një vend të lirë në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit (por jo për në gjykatën e specializuar).

Megjithatë, shembulli më i mirë do të ishte Italia, ku Këshilli i Lartë Gjyqësor shpall periodikisht një thirrje për vende të lira në gjykata të ndryshme dhe një magjistrat lejohet të aplikojë vetëm në tre pozicione të lira, njësoj si në Shqipëri, dhe ka gjithashtu detyrimin për t'i radhitur këto pozicione sipas preferencës. Nëse shpallet një thirrje tjetër, një gjyqtar mund të aplikojë për një vend të lirë vetëm nëse nuk e ka përdorur më parë të drejtën për të aplikuar në tre vende të lira.

Në fjalë të tjera, për çdo magjistrat nuk mund të ketë më shumë se tre procedura të hapura në lidhje me tre vende të lira.

Në fakt sistemi shqiptar duket të jetë i bazuar në modelin italian lidhur me këtë tematikë. Nëse një gjyqtar aplikon në thirrjen e radhës për një vend tjetër të lirë, ndërkohë që ka aplikuar më parë në tre vende të lira, aplikimi i tij i mëparshëm (aplikimi i radhitur i fundit) përfundon/përmbillet. Meqenëse në Shqipëri nuk ekziston një parashikim për përfundimin automatik të aplikimit të mëparshëm, Këshilli ka zbatuar saktë rregullin për të kërkuar nga kandidati renditjen e (maksimumi) me tre aplikimeve. Ky rregull është në favor të gjyqtarit aplikues dhe i jep atij mundësinë për të zgjedhur tre vendet e lira më të favorshme për të.

Përgjigjet e pyetjeve dhe përfundimet:

KLJG paraqiti tre pyetje lidhur me interpretimin sistematik të Nenit 48 (6) të Ligjit për Statusin.

Pyetja e parë dhe e dytë: Këto pyetje të KLJG janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën. Ato mund të përmbliidhen si më poshtë:

Nëse kufizimi i Nenit 48 (6) i Ligjit për Statusin zbatohet kur kandidati aplikon në procedura të ngritjes në detyrë të filluara në periudha të ndryshme kohore; Nëse kufizimi i Nenit 48 (6) i Ligjit për Statusin lejon një kandidat të aplikojë në procedura të ardhshme të ngritjes në detyrë duke rikonsideruar aplikimet e tij të mëparshme me qëllim respektimin e kufizimit të ligjit?

Bazuar në analizën e mësipërme, përgjigja e këtyre pyetjeve është se kufizimi i parashikuar nga Neni 48 (6) i Ligjit për Statusin do të zbatohet përpos faktit se kandidati po aplikon në procedura të ngritjes në detyrë të shpallura në periudha të ndryshme kohore. Konkretisht, nëse kandidati ka aplikuar tashmë për tre vende të lira në një procedurë të nisur më parë, ai mund të aplikojë për vende të tjera të lira në një procedurë ngritjeje në detyrë e cila fillon më pas, vetëm nëse një nga procedurat e nisura më parë është përmblyllur, ose për shkak të përfundimit të procedurës ose për shkak të tërheqjes së kandidatit nga aplikimi. Këtu ligji shqiptar duket të ketë ndjekur sistemin italian i cili gjithashtu vendos të njëjtin kufizim gjatë procedurës së ngritjes në detyrë.

Me fjalë të tjera, për të respektuar kufizimin e moskandidimit në më shumë se tre vende të lira, kandidati mund të aplikojë në procedura të ardhshme për ngritjen në detyrë,

edhe pse ai ka aplikuar më parë në tre vende të lira, duke u tërhequr nga një ose më shumë aplikime ose pas skualifikimit të aplikimit të tij.

Pyetja e tretë e KLGJ është identifikimi i interesit publik mbi kufizimin e parashikuar në Nenin 48 (6) të Ligjit për Statusin.

Në Nenin 48 (6), Ligji për Statusin duket se ka për qëllim të shmangë vonesa të mundshme gjatë procedurës së ngritjes në detyrë. Për shembull, në rast se Këshilli shpall shumë thirrje për vende të lira, të gjithë gjyqtarët mund të aplikojnë për tre vende në çdo thirrje. Kjo situatë do të ndikonte negativisht në efikasitetin e procedurës së ngritjes në detyrë. Më konkretisht Këshillit do t'i duhej të vlerësonte një numër shumë të madh aplikimesh, të merrte vendime për të gjitha vendet në të njëjtën kohë dhe t'i rendiste të gjitha në një listë, duke krijuar kështu vonesa. Më tutje, një kandidat mund të renditet i pari për disa vende të lira dhe në këtë skenar Këshilli do të duhej të kthehej pas tek kandidatët dhe t'i pyeste për preferencën e tyre. Si pasojë, do të ndodhte tërheqja nga vendet e tjera duke vonuar kështu procedurën e ngritjes në detyrë. Gjuha e Nenit 48 (6) kërkon nga gjyqtarët të cilët aplikojnë për ngritje në detyrë, një analizë më të thellë të mundësive dhe renditjes së tyre, sepse ata duhet të zgjedhin vetëm tre vende të lira dhe t'i rendisin ato sipas preferencës, pavarësisht nëse janë shpallur në një, dy ose tre thirrje të ndryshme.

Ngritja në detyrë e gjyqtarëve, në vetvete ka për qëllim garantimin e mirëfunksionimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe duket sikur kufizimi i vendosur nga Neni 48 (6) i Ligjit për Statusin kontribuon në mbrojtjen e interesit publik për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situatën aktuale kur Këshilli nuk është ende në gjendje të plotësojë të gjitha vendet e lira të shpallura në një thirrje brenda tre muajve nga data e hapjes së procedurës, në përputhje me Nenin 48 (2) të Ligjit për Statusin për shkak se procedura e ngritjes në detyrë zgjat më shumë, për arsye të ndryshme, pavarësisht Këshillit”.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se Këshilli duhet të diskutojë dhe të mbajë një qëndrim përfundimtar sa i përket shtrirjes së kufizimit të të drejtës së kandidimit sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin. Ky qëndrim është i rëndësishëm jo vetëm në kuadër të shqyrtimit të projektvendimit në shqyrtim, por edhe në çdo rast tjetër që ka të bëjë me procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Në supozimin që qëndrimi përfundimtar i Këshillit do të jetë i njëjtë me atë të mbajtur në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, atëherë mund të procedohet me shqyrtimin e projektvendimit sikurse ai është propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Në rast të kundërt, pra nëse qëndrimi përfundimtar i Këshillit do të jetë sipas opinionit ligjor të Misionit EURALIUS, atëherë është e nevojshme që përpara shqyrtimit të projektvendimit të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, katër kandidatëve, pra z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, që aktualisht rezultojnë të kenë kandiduar për ngritjen në detyrë në më shumë se tre pozicione të lira në proces shqyrtimi, t'iu kërkohet të rikonsiderojnë dhe të përcaktojnë tre pozicionet e lira për të cilat ata do të vijnë të kandidojnë. Në këtë rast, kandidatëve në fjalë duhet t'iu bëhet e ditur se nëse nuk rikonsiderojnë dhe të përcaktojnë tre pozicionet e lira për të cilat ata do të vijnë të kandidojnë, Këshilli do të ndjekë të njëjtin rregull të zbatuar dhe më parë, pra përcaktimin e tre pozicioneve të lira pikërisht të atyre të shpallura kronologjikisht më parë.

Së fundi, për disa nga pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura për ngritje në detyrë, brenda afatit të kandidimit, kandiduan edhe gjyqtarët znj. {...} dhe z. {...}, por ata, respektivisht në datat 16.06.2020 dhe 22.06.2020, u tërhoqën nga kandidimet.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga katër pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 21 kandidatët për pozicionet e lira, për të cilat fillon procedura e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit sipas pikës 1 të projektvendimit.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatët z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë

ose në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, procedurat e verifikimit të tyre sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe/ose në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndërkohë, pika 4 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020, për kandidatët znj. {...} dhe z. {...}, në kushtet e tërheqjes së tyre nga kandidimi respektivisht më datë 16.06.2020 dhe 22.06.2020.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, unë do të ftoja kolegët çfarë opinionit kanë lidhur me propozimin e dhënë nga EURALIUS dhe kush do jetë qëndrimi i Këshillit më tej për të vlerësuar këtë propozim.

Brikena Ukperaj: Çështja për të cilën Komisioni ka kërkuar opinion në fakt Misionit EURALIUS, lidhet me një çështje që unë e kisha ngritur si diskutim që në mbledhjen e mëparshme dhe që lidhet konkretisht me kufizimin e shtrirjes së të drejtës së kandidimit sipas nenit 48, pika 6 e ligjit për Statusin.

Në fakt, analiza që ka bërë Misioni EURALIUS, në të tre pyetjet e shtruar për diskutim nga Komisioni i Karrierës, vlerësoj që është ezaurues dhe personalisht jam dakord me qëndrimin që në të gjitha rastet, pavarësisht raundet e ndryshme që ne mund të kemi lidhur me shpalljen e procedurave të ngritjes në detyrë, për sa kohë këto procedura nuk kanë përfunduar, kandidati nuk mund të jetë pjesëmarrës në më shumë se tre pozicione të lira.

Unë jam dakord lidhur me propozimin ose si të them, sepse edhe nga Komisioni nuk është se vjen me një propozim, është thjesht diskutim që i është shtruar për zgjidhje ose për diskutim mbledhjes plenare; personalisht jam dakord me qëndrimin që për secilin kandidat që aplikon në pozicionet e shpallura për ngritjen në detyrë, pavarësisht kohës se kur shpallen këto procedura, kandidati nuk mund të jetë pjesëmarrës më shumë se në tre pozicione të lira shpallura, pavarësisht se ato mund të bëjnë fjalë për gjykatat e apelit apo për Gjykatën e Lartë.

Nuk e di se si do të procedojmë. Ndoshta duhet që të kemi një vendimmarrje dhe kjo vendimmarrje duhet të vijë me anë të një propozimi. Mund të shërbejë ky qëndrimi im një propozim për mbledhjen plenare, për t'u votuar lidhur me sa parashtrova.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ka ndonjë koleg ndonjë diskutim lidhur me çfarë u propozua nga zonja Ukperaj, nga zoti Toska, përpara se të hedhim një propozim konkret në votim.

Marçela Shehu: Kryetare, edhe unë bashkohem me qëndrimin që ka mbajtur Misioni EURALIUS si dhe me atë çka parashtroi zonja Ukperaj në mbledhje plenare. Edhe unë vlerësoj që duhet të ketë një vendimmarrje të Këshillit lidhur me këtë moment, pra i takon Këshillit që të vlerësojë që kandidatët nuk mund të aplikojnë në më shumë se tre pozicione të lira të shpallura, për sa kohë procedurat nuk kanë mbaruar. Pra të kalojmë fillimisht këtë propozim në votim, pasi ky propozim dhe vendimmarrja do të ndikojë edhe në të votuarit e projektvendimit që ka paraqitur më pas Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Ndonjë diskutim tjetër?

Fatmira Luli: Edhe unë jam dakord me sa propozoi edhe Marçela dhe Brikena. Mendoj që duhet ta hedhim në votim këtë propozim sepse pa u shqyrtuar ky, nuk mund të votohet projekt-akti që ka sjellë Komisioni. Kështu që e gjykoj që duhet të hidhet në votim ky, pastaj të votohet projekt-akti.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit, Fatmira!

Atëherë, ka ndonjë njeri tjetër ndonjë ide tjetër, përveç propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe të mbështetur nga zonja Shehu dhe zonja Luli?

Nëse jo, mund të procedojmë.

Atëherë, propozimi i bërë nga zonja Ukperaj dhe që i kërkohet Këshillit vendimmarrje është që çdo kandidat mund të konkurrojë në tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre.

Atëherë, votojmë lidhur me këtë propozim?

Brunilda Kadi: Më fal një sekondë, Kryetare!

Çfarë do votojmë? Është vendim, qëndrim, direktivë, rezolutë? Çfarë do votojmë?

Naureda Llagami: Bruna, është qëndrim.

Brunilda Kadi: Qëndrim është?

Naureda Llagami: Qëndrim pra sepse ky lloj qëndrimi afekton më pas edhe vendimmarrjet tona.

Brunilda Kadi: E kuptoj! Por çfarë lloj akti është ky që votojmë?

E kuptova. Por çfarë lloj akti është ky nga ana formale, që ne e votojmë?

Mos ndoshta ne duhet të marrim një rast konkret për një kandidat, marrim një vendim konkret dhe kjo tregon qëndrimin tonë në lidhje me këtë interpretim të ligjit? Si e mendoni? Se mua më duket pak si pa bazë formale kjo. Çfarë do votojmë? Si quhet ky akti që ne do votojmë? –Mendim? Qëndrim?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, Komisioni i ka kërkuar Këshillit që të mbajë qëndrim lidhur me kuptimin e zbatimit të pikës 6 të nenit 48 të ligjit për Statusin sepse kjo, në rastin e projektvendimit të paraqitur për shqyrtim implikon 4 kandidatë për të cilët, nëse Këshilli konsideron qëndrimin e Misionit EURALIUS dhe që u konsiderua nga të paktën tre anëtarët si më lart, do duhet që ne të vijojmë me njoftimet për katër kandidatët që t’iu mundësojmë atyre që të përcaktojnë tre pozicionet e lira për të cilët ata do të vijojnë kandidimin. Ky do të jetë efekti i qëndrimit që duhet të mbajmë lidhur me kuptimin e zbatimit të nenit 48/6 të ligjit për Statusin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë, unë do të sugjeroja që ndoshta ne të marrim kandidatin konkret, të parin sipas listës dhe hedhim në votim vendimin e Këshillit për ta njoftuar kandidatin për të zgjedhur sipas interpretimit të ligjit që u parashtrua. Në këtë rast ka kuptim dhe është një akt konkret dhe aty mbahet edhe qëndrimi që do jetë standard për herët e tjera, mbi bazën e këtij interpretimi. Secili nga anëtarët ka mundësi, përveç atyre të tre që u shprehën tani, të tjerët të mbajnë qëndrimin/interpretimin e tyre sipas ligjit. Se mua nga ana formale më duket problem që ne të votojmë formalisht një qëndrim. Se në mënyrë të votuari, nuk është një akt që e parashikon ligji që Këshilli ka një vendim në këtë formë.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, marrë shkas edhe nga ajo çka Komisioni ka parashtruar dhe nga çka parashtroi zonja Kadi, mundet që propozimi të riformulohet dhe të jetë: -A duhet të njoftohen katër kandidatët, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...} dhe zonja {...} për të përcaktuar tre pozicionet e lira për të cilat kandidojnë dhe janë në proces shqyrtimi përpara Këshillit.

Brunilda Kadi: Okej! Unë jam dakord me këtë sugjerim. Të hidhet në votim kjo që u formulua nga zoti Toska! Janë katër kandidatë që janë në këto kushte.

Naureda Llagami: Atëherë, riformulojmë edhe një herë. Të hedhim në votim propozimin e fundit të bërë nga zoti Toska, të riformuluar, i cili ka të bëjë me: -Njoftim për katër kandidatët për të përcaktuar tre pozicionet e lira që janë në proces të kandidimit, konkretisht kandidatët janë {...}, {...}, {...} dhe {...}. Jemi dakord që t'i njoftojmë këta kandidatë?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord. Që të mos përsëris, bashkohem me arsyetimin e tre kolegëve që ishin me këtë qëndrim. Pra jam dakord që të njoftohen.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që t'u njoftohet katër kandidatëve përkatësisht zoti {...}, {...}, {...} dhe {...} që aktualisht rezultojnë që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në më shumë se tre pozicione të lira në proces shqyrtimi, duke iu kërkuar të rikonsiderojnë dhe të përcaktojnë tre pozicionet e lira për të cilat ato do të vijnë që të kandidojnë. Pas marrjes së informacionit nga tre kandidatët, në pritje të këtij informacioni, kjo çështje nuk do të merret në shqyrtim nga Këshilli, duke u shtyrë për në seancën e radhës.

Marçela Shehu: Kryetare, mund të ndërhyj pak të lutem?

Para se të kalojmë tek pika e dytë, mos duhet të caktojmë një afat njoftimi, një afat që të ishte jo i gjatë, por i shkurtër, me qëllim që të mos na pengojë për vijimin e procedurave dhe më pas të shortit, pra për zotin {...}, zonjën {...}, {...} dhe {...}, të caktojmë një afat?

Naureda Llagami: Po Marçela, më jep një propozim si e gjykoni?

Marçela Shehu: Po duke qenë se nuk është se i duhet kandidatëve një kohë e gjatë për të vlerësuar dhe reflektuar, mendoj që deri nesër në përfundim të orarit zyrtar, do të ishte e mjaftueshme si kohë për kandidatët, me qëllim që në mbledhjen më të afërt më pas, të vijojmë me procedurat e shortit për të gjithë kandidatët.

Naureda Llagami: Dakord.

Jemi të gjithë dakord me afatin e propozuar nga zonja Shehu?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, ramë dakord që njoftimi do u bëhet kandidatëve dhe t'u lihet afat deri në ditën e nesërme, në orarin zyrtar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

1. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
2. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
3. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
4. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.
- 5 (shtesë). “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.
- 6 (shtesë). “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

- Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;
 - “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

3. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”;

4. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

5 (shtesë). “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

6 (shtesë). “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, në fakt janë 6 çështje. Fillohet me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, më pas është prapë “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, prapë çështja tjetër është “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë” dhe çështja tjetër është sërish e njëjta gjë po në Gjykatën e Posaçme. për një pozicion të lirë. Janë edhe dy çështjet shtesë që u miratuan, që kanë të bëjnë me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për një pozicion të lirë dhe hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Për më shumë detaje, fjalën për ia kaloj zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur katër projektvendime “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”. Në secilën nga projektvendimet bëhet

fjalë për një pozicion të lirë. Për të katër këto projektvendime është përgatitur një relacion shpjegues. Relacioni është shpërndarë paraprakisht. Shkurtimeisht ju parashtroj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lira, nëpërmjet Vendimeve nr. 93, nr. 94, nr. 95, nr. 96 dhe nr. 97, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet e respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritjeje në detyrë.

Pas përfundimit të afatit të pezulluar dhe më pas të zgjatur të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 29.04.2020, aplikoi një kandidat, ndërkohë që me Vendimin nr. 153, datë 06.05.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin e vetëm për këtë pozicion, duke caktuar dhe relatorin përkatës.

Ndërkohë, në procedurat e tjera të ngritjes në detyrë, konkretisht në procedurën e dytë, të tretë dhe të katërt, të hapura me Vendimet nr. 94, nr. 95 dhe nr. 96, datë 26.02.2020, brenda afateve të kandidimit, që kanë përfunduar respektivisht më datë 06.05.2020, 13.05.2020 dhe 20.05.2020, nuk aplikoi asnjë kandidat. Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në tre procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, meqenëse vijonin të ekzistonin të tre pozicionet e lira të hapura me vendimet si më sipër dhe do të duhet të plotësoheshin përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, Këshilli me Vendimet e tij nr. 162, nr. 163 dhe nr. 164, datë 28.05.2020, vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të tre këto pozicione të lira. Në këtë rast, afati i kandidimit u caktua tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, duke përfunduar ai më datë 22.06.2020. Në përfundim të afatit të kandidimit për këto tre pozicione të lira rezultoi të mos kishte kandiduar asnjë gjyqtar.

Përveç sa sipër, më datë 27.05.2020, përfundoi afati i kandidimit edhe për pozicionin e pestë të lirë, të shpallur me Vendimin nr. 97, datë 26.02.2020. Edhe për këtë pozicion të lirë rezultoi të mos kishte kandiduar asnjë gjyqtar.

Për rrjedhojë, në total, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë katër pozicione të lira, ndërkohë që vijon e njëjta nevojë për plotësimin e tyre.

Ndaj sa më sipër, KZHK ka propozuar katër projektvendimet për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira. Të katër projektvendimet titullohen “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Sipas projektvendimeve të propozuara, afati i kandidimit është vlerësuar të jetë i njëjti, konkretisht tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimeve, për secilën procedurë ngritje në detyrë, ato titullohen “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastin e hapjes fillimisht të procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët përpara se të kalojmë në vendimmarrje?

Nëse jo, atëherë kalojmë në vendimmarrje.

Në total janë 4 pozicione të lira që po rihapen për Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me një afat kandidimi, siç na relatoi zoti Toska, tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të njoftimit për rihapjen e ngritjes në detyrë.

Atëherë, jemi dakord për rihapjen e këtyre 4 pozicioneve të lira?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër e cila ka të bëjë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë” (nënpika 5 shtesë e pikës së 2 të rendit të ditës). Po, zoti Toska.

Illir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar edhe një projektvendim tjetër për hapjen tashmë të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Ky vendim merr shkas nga fakti se mbas shpalljes së pesë pozicioneve të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, katër nga të cilat ne sapo i

rihapëm përsëri, është krijuar edhe një pozicion tjetër i lirë për shkak të shkarkimit nga detyra të kësaj gjykate nga KPK.

Për këtë arsye, ndërsa për këtë gjyqtar deklaruar edhe mbarimin e caktimit të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, do duhet që Këshilli të hapë rishtazi këtë pozicion të lirë që është krijuar në këtë gjykatë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim mbi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Afati i kandidimit është tre javë nga disa e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër e cila ka të bëjë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë” (nënpika 6 shtesë e pikës së 2 të rendit të ditës). Sërish fjalën e ka zoti Toska!

(Zoti Toska shqyrton gabimisht çështjen nr. 3 në rendin e ditës “3.Shqyrtimi i projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës” dhe jo nëncështjen nr. 6 shtesë që hidhet për shqyrtim nga kryetarja).

Ilir Toska: Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe një projektvendim “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lira, nëpërmjet Vendimeve nr. 88, nr. 89, nr. 90, nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet e respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritje në detyrë.

Aktualisht kanë përfunduar afatet e pezulluara dhe më pas të zgjatura të kandidimit për të pesta procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 29.04.2020, aplikuan tre kandidatë, ndërkohë që me Vendimin nr.152, datë 06.05.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për tre kandidatët për këtë pozicion, duke caktuar dhe relatorët përkatës.

Në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e dytë të lirë të hapur me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 06.05.2020, aplikuan dy kandidatë, të cilat kishin aplikuar edhe për pozicionin e parë të lirë, ndërkohë që me Vendimin nr. 157, datë 15.05.2020, Këshilli filloi procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për dy kandidatët për këtë pozicion dhe

vendosi që procedura e verifikimit për këto dy kandidatë, filluar me Vendimin e tij nr. 152, datë 06.05.2020, ishte e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 89, datë 26.02.2020.

Në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e tretë të lirë të hapur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 13.05.2020, aplikuan tre kandidate, të njëjtat kandidate që aplikuan edhe për pozicionin e parë të lirë, ndërkohë që me Vendimin e tij nr. 190, datë 04.06.2020, Këshilli filloi procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për tre kandidatet për këtë pozicion dhe vendosi që procedurat e mëparshme të verifikimit për këto kandidate, ishin të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 90, datë 26.02.2020.

Në procedurën e katërt të ngritjes në detyrë, të hapur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 20.05.2020, aplikuan dy kandidate, njëra prej të cilave kishte aplikuar edhe për pozicionin e parë të lirë dhe një tjetër gjyqtare që aplikoi rishtazi, ndërkohë që me Vendimin nr. 191, datë 15.05.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për dy kandidatet për këtë pozicion, ku për kandidaten që kishte kandiduar edhe më parë, vendosi që procedura e mëparshme e verifikimit ishte e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e shpallur me Vendimin e tij nr. 91, datë 26.02.2020.

Ndërkohë, në procedurën tjetër të ngritjes në detyrë, konkretisht në procedurën e pestë, të hapur me Vendimin nr. 92, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, që ka përfunduar më datë 27.05.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurën si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në këtë të fundit vijon të ekzistojë një pozicion i lirë, i cili duhet të plotësohet përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Sipas projektvendimit të propozuar, afati i kandidimit është tre javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit, ai është strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, me përjashtim të afatit të kandidimit, si dhe në rastin e hapjes fillimisht të procedurës për ngritjen në detyrë për këtë pozicion të lirë.

Bashkëlidhur projektvendimit janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Aëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë. Afati i kandidimit është tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”. Sërish relator

i kësaj çështjeje është zoti Toska. (Kjo është çështja nr. 3 në rendin e ditës e cila u shqyrtuar dhe u trajtua më sipër nga zoti Toska.)

(Zoti Toska më poshtë shqyrton nëncështjen nr. 6 shtesë të pikës 2 e cila gabimisht u tejkalua në radhë “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”).

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe një projektvendim tjetër për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Kjo procedurë hapet rishtazi në kushtet kur në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është krijuar së fundi një pozicion i lirë për shkak të shkarkimit të një gjyqtari të kësaj gjykate nga KPK. Në këto kushte do duhet të hapim procedurat e ngritjes në detyrë edhe për këtë pozicion të lirë.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit, ai është i është i njëjtë si edhe në rastin e hapjes fillimisht apo rihapjes së procedurave të ngritjes në detyrë në këtë gjykatë. Ka ndryshim në raport me afatin e kandidimit me projektvendimet që kemi miratuar fillimisht, në këtë rast është parashikuar i njëjtë ky afat si për rihapjen e procedurave për Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ashtu si edhe për rihapjen e të njëjtës procedurë për ngritjen në detyrë për Gjykatën e Posaçme të Apelit, pra tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në diskutim nga kolegët? Kemi ndonjë koment, diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Afati i kandidimit edhe në këtë rast është tre javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 dhe 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

1. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”;
2. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”;
3. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 1. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”;
 2. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”;
 3. “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për sa i përket: rihapjes së procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile. Fjalën për relativimin e këtij projekt-akti e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe tre projektvendime për hipjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër. Për këto tre

projektvendime është parashtruar edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht po parashtroj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, më datë 28.05.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në disa gjykata apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr. 175, në Gjykatën e Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale sipas Vendimit nr. 177 dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr. 178.

Afati i kandidimit për të tre këto procedura ngritje në detyrë është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Ky afati për këto tre procedura ngritje në detyrë ka përfunduar më datë 15.06.2020.

Brenda afatit të kandidimit në këto tre procedura ngritje në detyrë nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në tre procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, në këto gjykata vijnë të ekzistojnë tre pozicione të lira, të cilat duhet të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar tre projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë (për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile), në Gjykatën e Apelit Korçë (për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale) dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër (për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile).

Sipas projektvendimeve të propozuara, mbi të njëjtat arsye si dhe në rastin e hapjes, më datë 28.05.2020, të procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Komisioni vlerëson që për secilën procedurë ngritjeje në detyrë, afati i kandidimit të jetë në kohëzgjatjen minimale të përcaktuar nga ligji, shkronja “a”, pika 5, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, pra dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimeve, për secilën procedurë ngritjeje në detyrë, ato kanë të njëjtin titull, ndërkohë që kanë edhe të njëjtën përmbajtje, pra të strukturuar në katër Krerë si dhe në rastin e hapjes fillimisht të procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim me tre projekt-aktet e propozuara?

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin e parë, i cili ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e së drejtës civile.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e së drejtës civile. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e së drejtës penale. Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Afati i kandidimit edhe në këtë rast është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e së drejtës civile. Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Afati i kandidimit është 2 javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e caktimit të përkohshëm në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtarës {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e caktimit të përkohshëm në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e caktimit të përkohshëm në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe transferimin e gjyqtares {...}”, projekt-akt i cili do të raportohet sërish nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim për mbarimin e caktimit të përkohshëm dhe transferimin e znj. {...}.

Sa i përket bazës ligjore të projektvendimit, nuk po zgjatëm, ato janë parashtruar në relacionin shoqëruar të projektvendimit. Është e njëjta bazë ligjore si në rastet që kemi marrë vendim të të njëjtës natyrë.

Sa i përket rrethanave faktike mund t’ju parashtroj se: Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 ka vendosur fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019. Sipas këtij vendimi Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për shkak të fillimit të funksionimit të kësaj gjykate, duke qenë përpara detyrimit

ligjor mbi caktimin e gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, në varësi të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori Vendimin nr. 292, datë 18.12.2019 “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarës znj. {...}”. Caktimi i përkohshëm i kësaj gjyqtareje u bë në kushtet e parashikuara nga neni 162, pika 3, e Ligjit për Statusin, pasi rezultoi se ndaj saj kishte filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mirëpo në datën 18.12.2019 ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e saj në detyrë, ndërkohë që ajo dhe familjarët e saj kishin dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Rezulton se në datën 17.06.2020 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi zhvillimit të seancës dëgjimore, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Në këto kushte, bazuar në neni 162, pika 4 të Ligjit për Statusin, që përcakton se: “... 4. Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi”, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të deklarojë të mbaruar caktimin e përkohshëm të gjyqtarës znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar edhe projektvendimin e paraqitur për shqyrtim përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Përveç sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor obligohet të caktojë gjyqtaren znj. {...} në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel gjykate, por me juridiksion të përgjithshëm, për sa kohë ajo, pavarësisht masës disiplinore të dhënë me një vendim që ende nuk është përfundimtar dhe pezullimit *ex lege* nga detyra e saj në pritje të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në rast ankimimi, sikurse përcakton neni 62, pika 1, e ligjit “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ajo vijon të ruajë statusin e magjistratit dhe të gëzojë të drejtën e pagës në masën 75 për qind të saj, sikurse përcakton kjo dispozitë e ligjit, por edhe neni F, pika 5, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në kushtet kur gjyqtarja znj. {...} është në pritje të marrjes së arsytimit të vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe më tej në rast të mosdakordësisë të paraqitjes së apelimit ndaj këtij vendimi dhe shqyrtimi më tej nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, dhe gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje, por gëzon vetëm të drejtën e pagës, duke konsideruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Këshilli në këtë rast, ndërsa ka detyrimin për të caktuar në një pozicion pune gjyqtaren në fjalë, do të duhet të konsiderojë po ashtu edhe funksionalitetin e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm ku gjyqtarja duhet të caktohet, në kuptimin që caktimi i saj në pozicion të mos pengojë plotësimin e vakancave emergjente në këto gjykata.

Për këtë, në pikën 2 të projektvendimit, është parashikuar që gjyqtarja znj. {...} transferohet në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar nga data 18.06.2020 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Një transferim i tillë i gjyqtarës znj. {...} garanton të drejtën aktuale që ajo gëzon nga pasja e statusit të magjistratit, pra të drejtën e pagës.

Nga ana tjetër, për garantimin e të drejtave që znj. {...} i rrjedhin nga statusi i magjistratit, të cilat bëhen efektive vetëm në rast të konfirmimit të saj në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar se ajo, në një rast të tillë, gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së dytë/apelit me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja "b", e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke pasur në konsideratë se transferimi i znj. {...} është pa pëlqim në kushtet kur për shkak të ligjit ajo ka dhënë pëlqim që të vijojë punën si gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sipas pikës 4 të projektvendimit parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në pikën 5 të projektvendimit parashikohet e drejta dhe afati i ankimit të gjyqtarit, konkretisht se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, projektvendimi përcakton hyrjen në fuqi menjëherë të tij, si dhe publikimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim përpara se ta kalojmë në votim projekt-aktin?

Nëse jo, atëherë hidhet në votim projekt-akti sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi deklarinimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm dhe transferimit të gjyqtares znj. {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mospranimin e kërkesës për përjashtimin nga caktimi në gjykata të tjera të gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mospranimin e kërkesës për përjashtimin nga caktimi në gjykata të tjera të gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mospranimin e kërkesës për përjashtimin nga caktimi në gjykata të tjera të gjyqtares {...}”. Relatimi i këtij projekt-akti do të bëhet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Me kërkesën e datës 10.06.2020 gjyqtarja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet i është drejtuar KLGJ-së për të kërkuar moscaktimin për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, duke paraqitur si argument problemet e shkaqeve shëndetësore. Kështu që në kërkesën e saj ajo ka paraqitur nga mjeku specialist, i cili daton në tetor 2019 rekomandimin për 14 ditë pushim të detyrueshëm.

Gjyqtarja shprehet në kërkesën e saj se për efekt të punës së bashkëshortit në sektorin e turizmit dhe udhëtimeve jashtë vendit nga ana e tij, e bëjnë të vështirë përkuqdesjen e vajzës së mitur e cila vuan nga dispalzia kokso femoral/ luxatio - onis dhe për të provuar këtë diagnozë ajo ka bashkëlidhur një vërtetim të Komisionit Mjekësor për Caktimin e Aftësisë në Punë (KPCAP-it), i cili përfshin një periudhë të përkohshme paaftësie 01.08.2018 – 01.08.2019 (pra pothuajse 1 vit). Në këtë vërtetim të KMCAP-it nuk parashikohet ndonjë e drejtë për përkuqdesjen e vazhdueshme nga ana e një personi për fëmijën. Ndërkohë që kjo e fundit pasqyrohet tek një formular i nënshkruar nga ana e një mjeku ortoped – traumatolog datë 04.09.2019.

Pra me këto lloj aktesh, gjyqtarja në fjalë kërkon të përjashtohet nga gjykimi i çështjeve të veçanta në gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin.

Këtë aspekt Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka rregulluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, i cili parashikon në pikën 6 se: “Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin deri në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta”.

Në fakt ish-KLD-ja ka reaguar për gjyqtaren në fjalë në raste të tjera, duke marrë për bazë aktet të cilat ajo ka paraqitur në kërkesat të cilat ka investuar këto organe administrative.

Në rastin konkret, Komisioni, pasi ka shqyrtuar aktet e paraqitura, ka konkluduar se kërkesa është e pabazuar në shkaqet e justifikuar provuese: së pari, dokumentacioni mjekësor daton në vitet 2018-2019, është i administruar më parë dhe në të nuk ka akte që të provojnë përkeqësimin e diagnozës, apo të ketë një monitorim të avancimit të sëmundjes në raport me aftësinë për punë, apo rekomandimin mjekësor që në mënyrë të detyrueshme të ndalojë udhëtimin me çdo mjet transporti. Gjithashtu Autoriteti Publik i caktuar nga Ligji (KMCAP-i), nuk ka parashikuar në vendimmarrjen e tij ndryshime apo avancime të sëmundjes në drejtim të përkeqësimit, për më tepër ai daton në fund, pra mbyll afatin e vëzhgimit, në fund të 01.08.2019.

Kështu që në këto kushte, duke vlerësuar aktet të cilat na janë paraqitur, Komisioni, pasi përpiloi draftin e vendimit, propozon që të mos pranohet kërkesa e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, ftoj kolegët, keni ndonjë diskutim për projekt-aktin?

Brikena Ukperaj: Alban, unë doja të pyesja nëse i është dhënë mundësia zonjës

{...} që të paraqesë prova, në mbështetje të pretendimeve të saj, qoftë edhe për të pasur akte që pasqyrojnë aktualisht gjendjen shëndetësore të saj ose të fëmijës; qoftë edhe për shkak të punës së bashkëshortit?

Alban Toro: Atëherë Brikena, unë nuk kam guximin t'i kërkoj një gjyqtareje se si të interpretojë aktet normative që ka prodhuar KLGJ-ja dhe format provuese kur ky akt normativ kërkon format provuese të shkaqeve të cilat kërkojnë përjashtimin, sepse prezumoj që një gjyqtar është i aftë t'i bëjë këto interpretime. Së dyti, nga një e-mail specifik në komunikim, nuk e di me kë, gjyqtarja në fjalë shprehet që dokumentacioni që ju më keni kërkuar, nuk mund ta marrë dot së shpejti. Në fakt, nuk kam pasur ndonjë komunikim si relator i çështjes dhe nuk e di nga është nisur gjyqtarja në fjalë për të administruar këtë lloj dokumentacioni, por gjendja faktike është kështu. Pra unë kam vlerësuar ato akte të cilat gjyqtarja ka vlerësuar se provon shkaqet e saj shëndetësore.

Brikena Ukperaj: Edhe një herë, që ta kuptoj.

Nuk ka paraqitur akët provuese apo...?

Alban Toro: Po! Aktet provuese të cilët janë bashkëlidhur...

Brikena Ukperaj: ... janë aktet provuese të gjendjes mbi të cilat Këshilli ka marrë një herë vendimin.

Alban Toro: Po! Bravo! Janë të vitit 21 shtator 2018, 12.05.2010, KMCAPI skadon në qershor të 2019, pra ka lënë një afat rikontrolli në qershor të 2019. Kam një rekomandim të lëshuar nga mjeku ortoped Gjergj Çausi 04.09.2019. Pra janë të gjithë akte të vjetra, me anë të së cilës prezumoj që KLD-ja dhe KLGJ-ja kanë dhënë vendimmarrjet e tyre të mëparshme kur i kanë akorduar këtë 6-mujorshin.

Brikena Ukperaj: Mirë! Faleminderit, Alban për sqarimin.

Alban Toro: Të lutem!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Erjon Muharremaj: Mundem zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Erjon!

Erjon Muharremaj: Atëherë, nga sqarimi i fundit që bëri zoti Toro, unë kuptoj që gjyqtarja ka nevojë për më tepër kohë për të paraqitur dokumentacion provues. Kështu që, unë propozoj që gjyqtarës t'i jepet mundësia të paraqesë dokumentacionin provues të

kohëve të fundit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Ajo që mendoj unë është që gjyqtarja ka konsideruar të paraqesë në Këshill një kërkesë, i ka bashkëlidhur dokumentacionin që ka vlerësuar të arsyeshëm që provon rrethanat që ajo pretendon dhe Komisioni ka konsideruar që provat janë shumë të hershme dhe nuk provojnë situatën sot. Nga ana tjetër, gjyqtarja ka përsëri të njëjtën të drejtë, siç kanë të gjithë gjyqtarët e tjerë, që mund të paraqesë një kërkesë të re dhe të sjellë, bashkë me të, dokumentacionin provues që provon faktet apo rrethanat aktuale të saj, të familjes apo të fëmijës. Kështu që, është e njëjta gjë sikur ne të procedojmë sot ajo të sjellë kërkesën nesër dhe do të duhet të marrim vendim, apo edhe ta shtyjmë seancën përsëri që t'i lëmë kohë që të sjelli të njëjtin dokumentacion. Më duket sikur do të vazhdojmë ta shtyjmë pafundësisht. Ajo mund ta sjellë edhe nesër një kërkesë të re dhe ne të marrim të shqyrtojmë menjëherë.

Brikena Ukperaj: Mund të them diçka zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Në fakt ne nuk kemi ndoshta rregulla procedurale më të detajuara të përcaktuara në rregullore, ku kemi vendosur lidhur me çështjet që gjyqtarët caktohen për të gjykuar në gjykata të tjera dhe aty kemi parashikuar edhe se kur mund të ndodhë përjashtimi nga delegimet apo nga ky caktim.

Për mendimin tim, edhe për të qenë operativ, që të mos dalim me dy vendime, sepse nëse do ta miratojmë sot, do themi që kërkesa është e pambështetur në prova, ndërkohë që gjyqtarja mundet që t'i sjellë provat në një moment të dytë, do të duhet prapë një vendimmarrje tjetër, unë jam dakord me mendimin e Erjonit që të jepet një mundësi/një afat, për të paraqitur prova lidhur me gjendjen aktuale shëndetësore të pretenduar të fëmijës së saj apo edhe të punës së bashkëshortit, me qëllim që Këshilli të vlerësojë bashkërisht për të arritur në një vendim; sepse sot në mungesë të provave, propozimi është që kërkesa nuk duhet të pranohet, ndërkohë që vet Komisioni ose kryetari i Komisionit e pranon faktin që gjyqtarja e ka mundësinë që të bëjë prapë një

kërkesë të dytë por që ta ketë të mbështetur në provat aktuale të gjendjes shëndetësore të saj apo të familjarëve.

Për të pasur një vendim, mendoj që mund t'i lëmë një afat, qoftë edhe 7ditë kohë, në kushtet kur ne ende nuk kemi për shqyrtim kërkesa për delegim ose nuk kemi në shqyrtim kërkesa për delegim ku mund të përfshihen gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe të vendosim lidhur me kërkesën mbas afatit që do të caktojë ose ta vlerësojë Këshilli si të nevojshëm. Ky ishte mendimi im.

Naureda Llagami: Atëherë, përpara se të kalojmë në shqyrtim projekt-aktin, hedhim në votim...

Brunilda Kadi: Një sekondë Kryetare, se doja të thoja diçka.

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë, si të shtyhet për t'i dhënë kohë gjyqtares të sjellë prova apo të rrezohet sot, rezultati është i njëjtë, që do të thotë, nëse sot do të hedhim në short caktim gjyqtarësh për gjykatat e rretheve gjyqësore, gjyqtarja do të përfshihet sepse si t'ia rrezojmë apo mos t'ia shqyrtojmë, rezultati është njësoj.

Tani, diskutimi këtu kam përshtypjen që është më tepër teorik dhe një lloj qëndrimi që duhet të mbajë Këshilli. Sipas Komisionit të Zhvillimit të Karrierës qasja është që një gjyqtar, kur vjen me një kërkesë konkrete, duhet ta dijë (prezumohet), që duhet ta dijë po aq mirë sa Këshilli sesi duhet të vijë dhe me çfarë provash duhet të vijë. Ndërkohë, nga dy anëtarët e tjerë u diskutua që “-Jo, ne t'ia japim këtë mundësi gjyqtarit”, dhe është thjesht çështje, kam përshtypjen, qëndrimi/qasje që ka gjithsecili.

Unë në këtë rast, duke qenë se pasojat në të dyja rastet për mua janë njësoj, pra nuk i cenohet më shumë në një rast sesa në rastin tjetër interesat e gjyqtares, mendoj që duhet të mbajmë qëndrimin me të cilin vjen Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që gjyqtari duhet ta dijë vetë këtë gjë, që kur vjen me një kërkesë, duhet t'i sjellë edhe aktet me të cilat ai pretendon se provon faktet ku bazon kërkesën. Kështu që eci me këtë qëndrim. Edhe unë jam me propozimin që vjen KZHK-ja.

Alban Toro: Dua të bëj edhe një sqarim, nëse më lejoni, për Brikenën. Mundem?

Mund të flas?

Naureda Llagami: Po!

Alban Toro: Brikena, nëse i referohemi akteve që kemi, por kryesisht KMCAPI-t i cili është organi i specializuar që verifikon edhe paaftësinë në punë, kontrolli i fundit duhet të ishte bërë në qershor të 2019-ës, ndërkohë që kërkesa nga ana e të interesuarës ka ardhur në shkurt (në mos u gabofsha) që daton në 10.06.2020. Pra ka pasur kohë të mjaftueshme për të provuar akte të tilla që justifikojnë gjendjen shëndetësore, qoftë për veten, qoftë për fëmijën.

Kështu që, në këtë kuadër, nuk e kuptoj pse duhet të shtyjme vendimmarrjen, kur në çdo moment akti nuk ka parashikuar limit. Akti për shkaqe shëndetësore, në çdo moment, e adreson KLGJ-në dhe e autorizon që të ndalojë delegime të gjyqtarëve të cilët kanë një problem shëndetësor, siç ka bërë në raste të tjera.

Kështu që, në këto kushte, mendoj që duhet ta miratojmë projektin e paraqitur sepse nuk ka shkaqe të tilla që ta provojnë gjendjen shëndetësore dhe ka qenë një kohë jashtëzakonisht të mjaftueshme për të reaguar dhe në plotësimin e akteve, të cilat ajo ka menduar se i provojnë këto shkaqe. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Alban!

Nëse nuk ka më diskutime, atëherë unë do doja që të hidhnim fillimisht propozimin e bërë nga zoti Muharremaj dhe zonja Ukperaj, që t'i jepet mundësi edhe një herë gjyqtarës për të parashtruar dokumentacionin përkatës për pamundësinë e saj për të qenë pjesë e skemës dhe më pas kalojmë në propozimin e Komisionit.

Kështu, kalojmë fillimisht me propozimin e bërë nga dy kolegët tanë.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Kalojëm tek propozimi i Komisionit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër, me arsyetimin që në respektim të procesit të rregullt, edhe një gjyqtari, minimalisht, duhet t'i njihen të njëjtat të drejta që i njihen çdo qytetari, për plotësimin e mangësive në dokumentacion.

Brikena Ukperaj: Në kushtet kur Këshilli vendosi me shumicë votash që nuk është e nevojshme që gjyqtarës t'i lihet kohë për të plotësuar dokumentacionin, me kushtet dhe me provat që ka bashkëngjitur kërkesës, edhe unë vlerësoj si Komisioni që nuk duhet të pranohet kërkesa, prandaj jam pro propozimit.

Medi Bici: Kundër, me të njëjtin arsyetim që bëri Erjoni.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Mospranimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e modelit të procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale. Projekt-akti do të relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Pas shumë relatimeve nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vazhdojmë me relatimin e një projekt-akti të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional të gjyqtarit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar disa akte nënligjore në funksion të plotësimit të skemës së vlerësimit.

Sa i përket dokumentimit të procedurës së shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, me qëllim pasqyrimin e saj në një formë standarde dhe të unifikuar, në nenin 13 pika 6 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, parashikohet se: “Zhvillimi i shortit dokumentohet me procesverbal sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli.

Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.” Po kështu, në pikën 19 të vendimit nr. 197, datë 11.6.2020, parashikohet se: “Çdo veprim i kryer gjatë procedurës së shortit dokumentohet në një procesverbal, sipas formës standarde të miratuar.”

Në zbatim të parashikimeve të mësipërme, është hartuar modeli i procesverbalit, ku do të pasqyrohen veprimet që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes të çështjeve me short, me qëllim dokumentimin e plotë dhe të saktë të procedurës si dhe garantimin e rregullshmërisë dhe transparencës në zhvillimin e procedurës së shortit. Dokumentimi i saktë i kësaj procedure, sipas një modeli të miratuar më parë, është i rëndësishëm, pasi përzgjedhja me short, është pjesë e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit dhe si e tillë mund të përbëjë shkak për ankim në gjykatë, referuar nenit 91 pika 6 dhe 95 pika 7 të ligjit për Statusin, të ndryshuar.

Në pjesën hyrëse të këtij model procesverbalit evidentohen elementët e domosdoshëm që pasqyrojnë vendin, kohën dhe qëllimin e procedurës së përzgjedhjes me short. Më pas dokumentohen pjesëmarrësit e detyrueshëm në procedurën e shortit, të cilët janë edhe subjektet përgjegjës për zhvillimin e saj si dhe pjesëmarrësit e tjerë që kanë të drejtë të marrin pjesë, në zbatim të pikës 4 të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020.

Në vijim, dokumentohet e gjithë procedura e përzgjedhjes me short, duke iu referuar hapave të përcaktuar në Kreun III të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020. Procedura e shortit fillon me hapin e parë për përzgjedhjen e çështjeve të gjykuara përtej afateve standarde dhe më pas me hapin e dytë për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin të përgjithshëm, sipas kategorive përkatëse.

Pas përzgjedhjes së çështjeve për secilën kategori dhe kryerjes së veprimeve verifikuese lidhur me kriteret e kualifikimit të çështjeve të përzgjedhura për vlerësim, sipas vendimit të relatorit, përshkruhen në procesverbal çështjet e përzgjedhura, duke evidentuar për secilën prej tyre, numrin dhe datën e regjistrimit si dhe numrin dhe datën e vendimit.

Në përfundim të procedurës për përzgjedhjen e të gjitha çështjeve me short, është pasqyruar në modelin e procesverbalit, një rubrikë në të cilën shënohen vërejtjet e mundshme të secilit pjesëmarrës (qoftë ky i detyrueshëm ose jo në procedurën e shortit) në lidhje me procedurën e zhvilluar, sipas pikës 20 të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020. Procesverbali në fund përmban pasqyrimin e orës së përfundimit të procedurës së shortit

si dhe nënshkrimet e të gjithë pjesëmarrësve.

Për sa më sipër, në pikën e parë të këtij projektvendimi është parashikuar miratimi i modelit të procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formës që i bashkëlidhet vendimit.

Në pikën e dytë të projektvendimit parashikohet miratimi i procesverbalit në formatin shkresor, format në të cilin ky procesverbal do të mbahet dhe administrohet në dosjen e vlerësimit të gjyqtarit.

Duke e konsideruar një akt administrativ që ka për qëllim miratimin e një modeli që dokumenton procedurat e përzgjedhjes me short, sipas rregullave tashmë të miratuara me vendimin nr. 197, datë 11.06.2020, i tillë që nuk vendos një rregullim të ri të detyrueshëm për zbatim, është parashikuar hyrja në fuqi e tij në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëngjitur relacionit është edhe modeli i procesverbalit që ju paraqitet sot për miratim. Faleminderit, zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Keni ndonjë diskutim në lidhje me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni përkatës?

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projektvendimit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e modelit të procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formës që i bashkëlidhet këtij vendimi. 2. Modeli i procesverbalit miratohet në formatin shkresor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër të radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të raportohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Meqenëse relacioni është vënë paraprakisht në dispozicion të të gjithë anëtarëve, unë do të përmendja shkurtimisht arsyet e këtij projektvendimi.

Tashmë, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka filluar procesin e gradimit për 18 gjyqtarë për të cilët vendimet e konfirmimit në detyrë kanë marrë formë të prerë. Mbas vendimit të parë që u mor nga mbledhja plenare lidhur me fillimin e procedurës, caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë ardhur edhe tre dosje të tjera me dokumentat e vlerësimit që janë marrë parasysh gjatë procedurës së rivlerësimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Konkretisht këta gjyqtarë janë: z. {...}, i cili është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 242, datë 28.02.2020, vendim që ka marrë formë të prerë më 12.06.2020; zoti {...} për të cilin vendimi ka marrë formë të prerë në të njëjtën ditë, ora 12.06.2020; znj. {...}, për të cilën vendimi ka marrë formë të prerë më 29.05.2019.

Në kushtet kur dosjet me materialet e vlerësimit kanë ardhur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni ka vlerësuar për të filluar edhe procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të tyre, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

Në pikën II përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12, pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 22.11.2019.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët, duke siguruar një shpërndarje të barabartë mes tyre. Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, vlerësojmë që të angazhohen të njëjtën nëpunës sikundër edhe në shortin e mëparshëm që janë znj. Esmerilda Habili, znj. Gilda Hoxha dhe z. Fatbardh Çoniku.

Lidhur me procedurën, Komisioni propozon të fillohet me përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, duke respektuar barazinë në shpërndarje, dhe pastaj sipas të njëjtit parim, të vazhdohet me përzgjedhjen e relatorit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Nëse nuk ka ndonjë sugjerim apo mendim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit, do të sugjeroja që të fillonim me përzgjedhjen e relatorit dhe të nëpunësit përgjegjës të vlerësimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, dakord me sugjerimin që u bë, që të fillojmë fillimisht me përzgjedhjen e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin.

Jemi dakord që të fillojmë me procedurën e përzgjedhjes me short për relatorin dhe për nëpunësit përgjegjës për vlerësimin?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, siç kemi vepruar gjithmonë, do të jenë tre enë. Në një enë do të jenë emrat e gjyqtarëve, në enën tjetër emrat e relatorëve dhe më pas emrat e nëpunësve përgjegjës.

Kështu le të vijojmë me përfshirjen brenda në enë të gjyqtarëve, konkretisht: gjyqtari {...}, gjyqtari {...}, gjyqtarja {...}.

Emrat e nëpunësve përgjegjës: Esmerilda Habili, Fatbardh Çoniku dhe Gilda Hoxha.

Emrat e anëtarëve të Komisionit: znj. Brikena Ukperaj, znj. Brunilda Kadi dhe z. Erjon Muharremaj.

(Fillon procedura e hedhjes së shortit)

Përzgjidhet emri i gjyqtarit të parë – z. {...}.

Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës – znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet emri i relatorit – znj. Brunilda Kadi.

Përzgjidhet emri i gjyqtarit të dytë – z. {...}.

Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës – znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet emri i relatorit – z. Erjon Muharremaj.

Përzgjidhet emri i gjyqtarit të tretë – znj. {...}.

Përzgjidhet emri i nëpunësit përgjegjës – z. Fatbardh Çoniku.

Përzgjidhet emri i relatorit – znj. Brikena Ukperaj.

Atëherë, me përfundimin e shortit, hedhim në votim projekt-aktin.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtarin z. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2. Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

3. Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}, projekt-akt i cili është përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur relacionin lidhur me verifikimin e plotësimit nga kandidati, z. {...}, të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 datë 26.02.2020 dhe për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020.

Kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kandiduar për pozicionet në fushën e së drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84 datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e së

drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86, nr. 87, datë 26.02.2020.

Me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 82 dhe nr. 85”, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë ... ku unë jam caktuar me anë të shortit si relatore për kandidatin z. {...}.

Ndërkohë, me vendimin nr. 201, datë 11.06.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Për kandidatët ..., z. {...}, të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 85, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre, sipas rastit, për një ose të dyja pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020. 3. Mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

Pas këtij momenti, ka vijuar procedura përkatëse e verifikimit lidhur me përmbushjen e kriterëve ligjore nga kandidati z. {...}, verifikim i cili kryhet bazuar në ligjin për Statusin dhe në vendimin nr. 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është verifikuar plotësimi i kriterit të përvojës profesionale të përgjithshme dhe minimale. Është verifikuar kriteri i mospasjes së masës disiplinore dhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale.

Lidhur me rezultatet e verifikimit që kanë rezultuar për kandidatin z. {...}: Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, me vendimin nr. 5, datë 01.07.1994 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës deri në tetor 1997 kur ka filluar Shkollën e Magjistraturës. Me vendimin nr. 50/1, datë 04.09.1999 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 2756, datë 27.09.2000, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier deri në vitin 2004 kur me Dekretin nr. 4193, datë 05.04.2004 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, dhe me vendimin nr. 290, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku vijon dhe sot ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, rezultojnë të ketë përvojë të përgjithshme profesionale, si ndihmësgjyqtar në gjykatën e shkallës së parë prej 3 vjet e 3 muaj, përvojë profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, prej 4 vjet e 6 muaj dhe përvojë profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së dytë, prej 15 vjet e 11 muaj. Pra rezultojnë që kandidati {...} përmbush kriterin e përvojës profesionale të përgjithshme, pasi rezultojnë të ketë mbi 13 vjet përvojë profesionale në gjykatat më të ulëta.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, evidentohet se kandidati ka përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës civile dhe administrative, siç do të referohet në vijim.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezultojnë se: “Gjyqtari {...} ka ushtruar funksionin e ndihmësgjyqtarit

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, prej datës 01.07.1994 deri më tetor 1997. Gjatë kësaj periudhe ai ka gjykuar çështje të karakterit civil dhe penal. Rezulton se në çështjet civile përfshihen dhe çështjet administrative.

Sipas statistikave të paraqitura rezulton se gjyqtari për këtë periudhë ka gjykuar në vitin 1994 - 128 çështje civile ku ndër to 9 janë çështje administrative, në vitin 1995 - 222 çështje civile ku ndër to 24 janë çështje administrative, në vitin 1996 - 264 çështje civile ku ndër to 26 janë çështje administrative, në vitin 1997 - 116 çështje civile ku ndër to 11 janë çështje administrative, në total 730 çështje civile ku ndër to 70 çështje janë administrative”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se: “Gjyqtari {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, prej datës 04.09.1999 deri më 27.09.2000. Gjatë kësaj periudhe ai ka gjykuar çështje të karakterit civil dhe penal. Sipas statistikave të paraqitura rezulton se gjyqtari për këtë periudhë ka gjykuar 40 çështje civile në të cilat përfshihen 6 çështje administrative”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se: “Gjyqtari {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, prej datës 27.09.2000 deri më datë 05.04.2004. Gjatë kësaj periudhe ai ka gjykuar çështje të karakterit civil (ku përfshihen dhe çështje administrative) dhe penal.

Sipas statistikave të paraqitura rezulton se gjyqtari për këtë periudhë ka gjykuar në vitin 2000 - 30 çështje civile ku ndër to 2 janë çështje administrative, në vitin 2001 - 144 çështje civile ku ndër to 7 janë çështje administrative, në vitin 2002 - 96 çështje civile ku ndër to 8 janë çështje administrative, në vitin 2003 - 212 çështje civile ku ndër to 9 janë çështje administrative, në vitin 2004 - 37 çështje civile ku ndër to 1 është çështje administrative, në total 519 çështje civile, ku ndër to 26 janë çështje administrative”.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 82, 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile dhe administrative, nga të cilat 3 vjet e 3 muaj si ndihmësgjyqtar në gjykatën e shkallës

së parë dhe 4 vjet e 6 muaj si gjyqtar.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore. Rezulton se zoti {...} nuk ka në fuqi masë disiplinore, nuk ka marrë ndonjëherë masë disiplinore dhe nuk ka probleme lidhur me kriterin e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, çështja i ka kaluar për shqyrtim Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili deri në këtë fazë e ka vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit për këtë kandidat duke vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar ky i fundit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, si dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë. Ky është edhe propozimi që vjen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Unë, me cilësinë e relatores do doja të ndalesha në dy momente ligjore që unë vlerësoj që duhen trajtuar dhe duhen diskutuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nuk vijnë në formën e një propozimi konkret, vijnë në formën e një diskutimi, duke vlerësuar se bazuar në diskutimet përkatëse, nëse do të jetë e nevojshme, mund të konkludohet edhe me një vendimmarrje të caktuar.

Fillimisht, një nga momentet që unë me cilësinë e relatores vlerësoj se duhet të trajtohet dhe diskutohet nga Këshilli, është diskutimi lidhur me përvojën profesionale si ndihmësgjyqtar të kandidatëve të cilët rezultojnë nga të dhënat përkatëse, që një periudhë të përvojës profesionale e kanë si ndihmësgjyqtar dhe një pjesë të përvojës profesionale e kanë si gjyqtar. Vlerësoj që kjo të trajtohet, me qëllim që Këshilli të vlerësojë nëse kjo përvojë, në kuptim të ligjit, duhet të barazohet me përvojën profesionale si gjyqtar. Ndaj në këtë moment unë mendoj që Këshilli duhet të vlerësojë dhe të mbajë një qëndrim nëse kjo përvojë do të konsiderohet për efekt të vjetërsisë në punë por nuk do të konsiderohet përvojë e njëjtë profesionale me përvojën e gjyqtarit; ose Këshilli do të mbajë qëndrimin tjetër që kjo përvojë do të konsiderohet përvojë profesionale e njëjtë pra barazohet me përvojën profesionale të gjyqtarit, pavarësisht rolit të funksionit si ndihmësgjyqtar që rezulton të ketë ushtruar ndihmësgjyqtari.

Nëse Këshilli do të konkludojë sipas njërit variant, pra që kjo periudhë nuk do të

konsiderohet e njëjtë me periudhën e gjyqtarit, atëherë do duhej që në këtë moment, për këtë kandidat apo për të gjithë kandidatët që kanë të njëjtën situatë, të konstatohet gjetja në procedurën e verifikimit dhe më pas kjo gjetje t'i komunikohet kandidatit për të mbajtur qëndrimin përkatës lidhur me këtë moment ligjor.

Momenti i dytë ligjor që unë do doja të diskutoja, ka lidhje me përvojën profesionale specifike që ne duhet të konsiderojmë në çdo rast konkret.

Marrë shkas për të ngritur këtë diskutim, bazuar në të dhënat që ne na rezultojnë për gjyqtarin z. {...}, mendoj edhe për ndonjë kandidat tjetër, por duke qenë se po trajtojmë fillimisht relacionin që lidhet me zotin {...}, nga të dhënat që rezultojnë lidhur me gjykimin e çështjeve administrative që ky gjyqtar, si me cilësinë e gjyqtarit, si me cilësinë e ndihmësgjyqtarit ka gjykuar.

Kështu rezulton që lidhur me përvojën profesionale specifike në fushën e së drejtës civile, nuk ka vend për diskutime, pasi rezulton që gjyqtari, në të gjithë karrierën e tij profesionale si ndihmësgjyqtar apo gjyqtar, ka gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh ashtu siç edhe ju janë relatuar në relacionin që ju tashmë dispononi, por ndërkohë rezulton që numri i çështjeve administrative që ka gjykuar ky gjyqtar si ndihmësgjyqtar apo si gjyqtar është shumë i vogël, krahasimisht me numrin e çështjeve civile.

Rezulton për shembull që për periudhën që ai ka gjykuar si ndihmësgjyqtar ('94-'97) në total 730 çështje civile, ndër këto 70 janë çështje administrative. Pra në të gjithë kohëzgjatjen e përvojës së tij profesionale si ndihmësgjyqtar, numri i çështjeve administrative është 70. I njëjti fakt konstatohet edhe në periudhën që ai ka gjykuar si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, ku rezulton që numri i çështjeve administrative, krahasimisht me numrin e çështjeve civile është shumë i ulët. Kështu, në vitin 2000 rezulton të ketë gjykuar 30 çështje civile, ndër to 2 janë çështje administrative, në vitin 2001 - 144 çështje civile ku ndër to 7 janë çështje administrative, në vitin 2002 - 96 çështje civile ku ndër to 8 janë çështje administrative, në vitin 2003 - 212 çështje civile ku ndër to 7 janë çështje administrative, në vitin 2004 - 37 çështje civile ku ndër to 1 është çështje administrative, në total 519 çështje civile, ku ndër to 26 janë çështje administrative.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës nuk ka vlerësuar gjatë fazës që çështja ishte

akoma tek relatori apo në Komision për të konstatuar gjetje për këtë moment ligjor lidhur me kandidatin {...}, për shkak se, as në ligj por as edhe në rregulloren për ngritjen në detyrë, nuk ka një përkufizim apo një përcaktim të qartë të përvojës profesionale specifike apo të numrit të çështjeve që duhet të ketë gjykuar një gjyqtar, numër i tillë që të përcaktojë nëse kjo përvojë do të konsiderohet përvojë e mjaftueshme profesionale specifike apo jo, prandaj dhe komisioni nuk ka vijuar më tej, pra nuk ka konkluduar se ka një gjetje dhe nuk ka konkluduar për t'ia komunikuar kandidatit. Por në cilësinë e relatores, unë mendoj që ky është një moment juridik që duhet trajtuar, jo vetëm për zotit {...}, por në situatën e zotit {...} mund të kemi edhe shumë kandidatë të tjerë që kandidojnë jo vetëm për në Gjykatën e Lartë, por mund të kandidojnë edhe për procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit, ndaj mendoj që të dyja këto çështje, pra si çështja e pozitës së ndihmësgjyqtarit ashtu edhe përcaktimi i përvojës profesionale specifike, duhet të trajtohen nga Këshilli. Faleminderit, Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela për relatimin!

Do të ftoja kolegët lidhur me çështjet që ka ngritur për diskutim relatorja, përpara se të kalojmë në vendimmarrje.

Ilir Toska: Mund të flasë?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, marrë shkas nga diskutimi që bëri Marçela, Këshilli do duhet të konsiderojë për ato dy rrethana që zonja Shehu përmendi, nëse ka vend që për kandidatin zotit {...} të bëhet një njoftim për gjetje, pra për një rrethanë që mund të çojë në skualifikimin e tij.

Sa i përket diskutimit unë mendoj se diskutimi duhet të jetë përfundimtar, pra që Këshilli të vlerësojë dhe të vendosë përfundimisht që njëra apo tjetra rrethanë çon patjetër në skualifikim, pasi nëse do të ndodhë kjo gjë, atëherë procesi i mëpasshëm ka përfunduar, pra çështja është mbyllur që në këtë moment.

Mendoj që gjithsekush nga anëtarët nëse ka një opinion që ka një rrethanë që mund të çojë në skualifikim në hipotezë, të mund të shprehet përmes një votimi apo edhe një diskutimi, jo thellësisht ligjor, pra ta çojë diskutimin deri në fund.

Sa i përket mua, mendoj që për të dy rrethanat që zonjë Shehu evidentoi, që rezultoi nga verifikimi i kritereve për kandidatin zotin {...}, nuk janë të atilla që mund të çojnë në skualifikim. Nisur nga kjo, unë do të isha kundër një njoftimi për gjetje për kandidatin zotin {...}, për të dy rrethanat e përmendura. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë personalisht, edhe në mbledhjen e mëparshme të Këshillit, i kam mëshuar faktit që Gjykata e Lartë duhet të ndërtohet dhe duhet të funksionojë me gjyqtarë të specializuar sipas fushave. Por, pavarësisht kësaj, lidhur me çështjet që ngre relatorja, duke filluar me faktin e mbajtjes së një qëndrimi paraprakisht lidhur me konsiderimin e përvojës si ndihmësgjyqtar apo jo për efekt të përvojës profesionale që kërkon neni 48, në qoftë se ne sot do të diskutonim dhe do të jepnim një qëndrim, unë nuk e di se çfarë gjetje do t'i kishim komunikuar gjyqtarit se ne do kishim marrë vendim. Pra nëse ne sot vlerësojmë që kjo periudhë nuk duhet të konsiderohet dhe duhet t'i komunikohet si gjetje, në fakt ne kemi marrë vendimin e skualifikimit në thelb.

Marçela Shehu: Brikena, të lutem, më fal që po të ndërpres.

Ajo që relatova ishte pikërisht kjo, që Komisioni, deri tani, ka vlerësuar që nuk ka vend për gjetje sepse nuk ka gjetur bazën ligjore për ta bërë vet si Komision për të konstatuar gjetje. Por nëse Këshilli e vlerëson, atëherë ne nuk vendosim skualifikimin, mund të konstatojmë që ka një gjetje, e cila i komunikohet kandidatit dhe pas dëgjimit të kandidatit, Këshilli prapë mund të shkojë në konkluzionin që nuk ka vend për skualifikim dhe mund të vendosi kualifikimin.

Brikena Ukperaj: Marçela, të lutem! Nëse ne do mendojmë që ka vend për gjetje është e lidhur patjetër me interpretimin që do t'i bëjmë përvojës profesionale si ndihmësgjyqtar.

Marçela Shehu: Sigurisht!

Brikena Ukperaj: Nuk mund të jetë e shkëputur. Dhe nga momenti që unë do them që kjo përvojë profesionale duhet të konsiderohet apo jo, automatikisht ose në

mënyrë të nënkuptuar e kam marrë vendimin e skualifikimit për gjyqtarin sepse zoti {...} nuk e plotëson me periudhën që ka gjyqtar përvojën profesionale prej 5 vjetësh, -e para, doja ta diskutoja në këtë këndvështrim.

Ndërsa, lidhur me numrin e çështjeve, për mendimin tim, është e rrezikshme në këtë moment që të vendosim një minimum apo maksimum çështjesh kategorie që gjyqtari duhet të ketë gjykuar, për t'u kualifikuar apo për t'ia konsideruar si përvojë profesionale specifike. Pse? –Unë kam punuar vet në një gjykatë të vogël. Të gjithë çështjet civile dhe administrative gjykoheshin edhe nga gjyqtarët që ishin në seksion administrativ, pra gjyqtarët e seksionit administrativ gjykonin edhe çështje civile edhe administrative. Duke qenë se çështjet administrative ishin të vogla në numër, plotësoheshin me çështje civile.

Por çfarë ndodhte? – Në atë moment nuk kishte një kategorizim, siç ka sot, se ç'është çështje civile dhe ç'është çështje administrative. Mund të ketë ndodhur, dhe besoj që ka ndodhur, që të gjitha konfliktet (shembull) me gjendjen civile, regjistroheshin si çështje civile, ndërkohë që sot, ato janë çështje administrative. Pra në qoftë se do t'i futemi këtij diskutimi, ndoshta mund të gabojmë në lëndën që ka pasur çështja që ka gjykuar. Mund të ketë ndodhur që zoti {...} ose edhe ndonjë gjyqtar tjetër, në shumicën e çështjeve civile, të ketë gjykuar edhe çështje administrative, që sot konsiderohen të tilla. Marr marrëdhëniet e punës, marrëdhëniet e punës të gjitha gjykoheshin nga seksionet civile. Sot, ato që rregullohen me ligj të posaçëm, pas ndryshimi të fundit, i ka gjykata administrative. Përpara ndryshimeve të fundit, nga 2013, kur u krijua, i gjykonte të gjitha gjykata administrative.

E them këtë panoramë të faktit për të vënë në mendje të gjithë anëtarëve, që do të ishte shumë e rrezikshme që me këto statistika që na vijnë ne nga gjykatat, të përcaktojmë përvojën specifike të gjyqtarit. Sepse edhe në fund të fundit, këto statistika janë statistika të përpunuara nga kancelarët. Ndoshta në këtë moment, çështjet administrative konsideroheshin vetëm çështjet që ishin me tatimet, doganat, etj. Volumi i çështjeve që sot konsiderohen administrative, dikur më përpara janë konsideruar çështje civile. Për këtë shkak, për faktin që të vendosësh rregulla loje mbasi ne kemi hapur procedurat për të tjerët sepse në qoftë se ne do themi “mbi këtë minimum” ose “në këtë minimum”, këtë gjë nuk e kemi bërë për pozicionet e tjera që kemi shpallur. Do të ishte përsëri e rrezikshme.

Kështu që, në vlerësimin tim, të bazohesh dhe të arrish në konkluzione për pasjen ose jo të një përvojë specifike të fushës vetëm për shkak të numrit të çështjeve që ke gjykuar, nuk është e drejtë për gjyqtarin por edhe e vendos në pozita të pabarabarta me gjyqtarët që ndoshta, jo për faj të tyre, nuk kanë pasur çështje të kësaj natyre në gjykatat ku ata kanë gjykuar.

Në vlerësimin tim, numri i çështjeve nuk mund të merret në konsideratë për të thënë nëse gjyqtari ka përvojën profesionale specifike ose jo, për të gjitha argumentat që thashë më lart. Ndërsa, për sa i përket periudhës së të gjykuarit si ndihmësgjyqtar, unë vlerësoj që nëse ne sot do të kemi një qëndrim dhe një votim sepse secili nga ne do të japë qëndrimin e tij, kjo do të çonte automatikisht në qëndrim përfundimtar për kualifikim ose skualifikim të kandidatit. Faleminderit!

Marçela Shehu: Për të qartësuar diçka.

Unë nuk kundërshtoj asgjë nga analiza e faktit dhe e ligjit që bën zonja Ukperaj, pasi unë personalisht nuk erdha me një propozim konkret. Unë e theksova disa herë, që as unë me cilësinë e relatores dhe as Komisioni nuk ka vlerësuar se ka vend për gjetje sepse do ia kishte komunikuar, por me cilësinë e relatores unë kam për detyrë dhe përgjegjësi që të dhënat të prezantohen ashtu siç duhen përpara Këshillit dhe t'i vihet theksi atyre momenteve që relatori vërtet mendon që ka vend për një diskutim, qoftë për të arritur edhe në këtë konkluzionin që thotë zonja Ukperaj.

Ndërsa lidhur me diskutimin e ndihmësgjyqtarit, mbase kjo në mënyrë indirekte çon në skualifikim, por që është një moment që unë mendoj që duhet trajtuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Alban Toro: A mund të ndërhyj thjesht për këtë moment?

Naureda Llagami: Po, Alban!

Alban Toro: Atëherë, aktualisht relatorja ka sjellë në vëmendje të Këshillit një rrethanë, një interpretim ligjor, i cili më pas, nëse do të jetë interpretim i përgjithshëm i gjithë Këshillit, ajo do të konsiderohet gjetje. Fakti që do të konsiderohej gjetje (se nuk e

dimë a do të konsiderohet), nuk passjellë detyrimisht shprehjen e vullnetit të KLGJ-së për ta përjashtuar nga konkurrimi i ardhshëm sepse mund të ndodhë që, në momentin që i vihet në dispozicion kandidatit, në aftësinë e gjërave të thella që ai mund të ketë, mund të bindë Këshillin që ai interpretim që ka bërë për rastin konkret në këtë rrethanë ligjore, të jetë i gabuar dhe normalisht do të ndryshojë edhe vullnetin e Këshillit. Pra teorikisht duhet të jetë Këshilli ai që në një mënyrë të përgjithshme, pra ose me shumicë votash, të bëjë një interpretim të këtij fakti/të kësaj rrethane, nëse është në këndvështrimin e lejuar nga ligji, për të konkurruar dhe për të vijuar më tej procedurat e konkurrimit. Është i njëjti rast që do të përsëritet edhe për kandidaten e ardhshme, për të cilën unë jam relator, për të cilën unë kam vepruar në të njëjtën “modus operandi”, domethënë me të njëjtën procedurë, duke sjellë në vëmendje që do ta sjellë në vëmendje të Këshillit për të njëjtin shkak. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Ndonjë vlerësim apo konsideratë nga kolegët për çështjen që po diskutojmë?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, sa i përket çështjes së përvojës së kandidatit si ndihmësgjyqtar, nëse është ajo përvojë, do duhet të konsiderohet si përvojë si gjyqtar, unë kam mendimin dhe vlerësimin se do duhet të konsiderohet e tillë. Nëse dikush nga kolegët mendon në mënyrë hipotetike që kjo nuk mund të konsiderohet si e tillë, pa arsyetuar gjerësisht, mundet ta shprehë këtë gjë dhe nëse shumica mendon në të njëjtën mënyrë, do duhet të bëjmë një njoftim për gjetje. Edhe unë mendoj që nuk mundet të marr një vendim për interpretimin e kësaj shtate, pra për interpretimin ligjor tani sepse nëse e marrim një vendim të tillë atëherë nuk do të ketë më kuptim të bëjmë gjetje sepse do të ishim të paragjykuar, se do konsiderohej që Këshilli e mori vendim tashmë. Prandaj ju ftova që diskutimi të mos jetë kaq i thelluar, por në pikëpamjen formale, nëse dikush ka këndvështrime që mund të çojë në skualifikim, të konsiderojë një gjë të tillë dhe ta shprehë. Unë personalisht kam vlerësim të ndryshëm dhe konsideroj që përvoja si ndihmësgjyqtar do duhet të barazohet me përvojën si gjyqtar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Bici!

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Meqenëse mua më takon të jem një nga ndihmësit më të vjetër të sistemit, kam të njëjtin mendim me zotin Toska dhe do t'i listoj arsyet: Sepse para se të vinim ne si ndihmës efektivë, ndihmësit në gjykatë kanë qenë ndihmës që vinin nga institucionet shtetërore ose nga ndërmarrjet shtetërore dhe nuk paguheshin nga gjykata por ato paguheshin nga ndërmarrjet nga vinin (nga puna e tyre), ndërsa në dhjetor të vitit '93 u bë ky ndryshim dhe ndihmësit ishin ndihmësgjyqtar efektiv quheshin, merrnin pjesë në trupa në të gjitha çështjet gjyqësore, kishin të drejtën e votës njësoj si gjyqtari, e linin gjyqtarin në pakicë, arsyetonin çështje, vjetërsia e tyre për efekt pagese, tani që kemi marrë vjetërsinë është njohur në rastet kur janë emëruar inspektorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo pjesë e punës së ndihmësve është llogaritur afati 5-vjeçar; kështu që për mua nuk duhet të vihet në diskutim kjo çështje.

Edhe çështja tjetër që shtron zonja relatores, jam dakord me arsyetimin e zonjës Brikena. Unë e thashë me pak fjalë, e thashë pak indirekte kur votova për zonjën Albana Boksi, që thashë që ka shqyrtuar të gjitha çështjet civile. Çështjet civile dhe çështjet administrative para vitit 2013 ishin të përbashkëta, edhe në Gjykatën e Lartë. Ai gjyqtar që gjykonte çështjet civile, gjykonte edhe çështjet administrative. Ndarjet u bënë vetëm në vitin 2013. Kështu që, ne nuk duhet të marrim për bazë sasinë dhe ky është qëndrim i mbajtur, e kemi mbajtur edhe më herët, kështu që kam të njëjtin mendim me zotin Ilir dhe zonjën Brikena.

Maksim Qoku: Kryetare, mund të them diçka?

Naureda Llagami: Po, e ka kërkuar fjalën zonja Kadi fillimisht, me shkrim dhe më pas Maksim. Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Tani, nisur sipas rendit kronologjik, mbas asaj që u diskutua nga relatorja dhe nga ajo çka u diskutua nga Brikena, u duk sikur ne në fillim do të diskutonim në parim a mund të jetë kjo në formën e gjetjes apo jo dhe me sa kuptova unë, Brikena ishte me

mendimin që s'mund të jetë gjetje sepse bëhet fjalë për interpretim të ligjit dhe nuk ka kuptim që ne do shprehim mendimin sot të gjithë, gjithsecili nga ne se si e interpreton ligjin për këtë situatë dhe pastaj t'ua njoftojmë atyre si gjetje, ndërkohë nuk ka kuptim që mbasi t'i dëgjojmë kandidatët, të ndryshohet mendimi nga secili nga anëtarët për shkak të qëndrimit të tyre në lidhje me interpretimin e ligjit.

Ndërkohë, me sa kuptova nga diskutimi i Ilirit dhe i Mediut, ata u shprehën edhe në themel për interpretimin e ligjit, si e interpretojnë ata situatën, kështu që, tani unë nuk e di?! Për vete jam konfuzë! Si do vazhdohet diskutimi? Do diskutojmë në parim do ta bëjmë apo s'do ta bëjmë si gjetje dhe të ecim me atë që u duk sikur propozoi në fillim Iliri, pra mos të shprehemi por thjesht t'ia çojmë kandidatit që është ky diskutim dhe çfarë mendimi keni ju, dhe pastaj, duke i marrë të gjitha për bazë, të konkludojmë.

Tani u konfundua situata. Nëse filluam të ecim dhe të diskutojë gjithsecili për themelin e diskutimit, pra se si e interpreton secili situatën, unë kam nevojë të ma qartësojë këtë gjë edhe Iliri dhe Mediu. Si mendoni, të shprehemi të gjithë për themelin?

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Fjalën e ka Maksim, pastaj Iliri.

Maksim Qoku: Jo! Le të flasë Iliri se e ka në lidhje me Brunën.

Naureda Llagami: Dakord.

Zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, ajo që unë shpreha, nuk ishte se bëra ndonjë interpretim të ligjit në mënyrë të hollësishme, thjesht shpreha vlerësimin tim se si ligji, sipas meje, konsiderohet për gjyqtarët dhe për ndihmësgjyqtarët. E thashë këtë në funksion të asaj që shpreha, se sipas meje nuk ka vend që Këshilli t'i bëjë njoftim për gjetje kandidatit. Nëse dikush nga anëtarët mendon që me një vlerësim ndryshe të ligjit, pra me një interpretim ndryshe, do duhet të bëjmë një njoftim për gjetje, pa i hyrë debatit më thellë, mund të votojmë propozimin që ka një prej anëtarëve për këtë gjë, pra për një njoftim për gjetje, t'ia bëjmë, të dëgjojmë edhe gjyqtarin dhe pastaj edhe të diskutojmë për interpretimin e ligjit në rastin konkret. Kjo ishte ajo që unë u përpoqa të thosha dhe mendoj që duhet të procedojmë. Unë nuk mendoj që duhet ta ndajmë paraprakisht të mbajmë qëndrim se si

duhet ta interpretojmë ligjin në këtë moment sepse do paragjykohe mi dhe kandidati ka gjithë të drejtën të thotë që tashmë e morët vendimin. E thënë në mënyrë të supozuar që është kjo rrethanë, që edhe mund të sjellë skualifikim, për shkak edhe këtij përcaktimi ligjor, nuk është paracaktuese sipas meje. Thjesht kandidatit i jepet mundësia që të shprehet për këtë rrethanë faktike të tij në raport me ligjin.

Brunilda Kadi: Atëherë, Ilir mund ta hedhim në votim këtë idenë tuaj që fillimisht secili nga ne të votojë me këtë procedurë, pra le t'i çohet kandidatit (jo në formën e gjetjes, se po është gjetje, i bie që ti ke konkluduar që është kështu) pra është ky diskutim në lidhje me këtë fakt, çfarë qëndrimi keni juve?, -dhe pastaj të shprehet Këshilli. Mos të jetë në formën e gjetjes sepse është interpretim ligji. Të gjejmë një formë, jo gjetje sepse gjetje do të thotë që ne e kemi mbajtur qëndrimin. Le të shprehen edhe ata sepse mund të kenë një argument më tepër që asnjërit nga neve mund të mos i ketë shkruar mendja. Patjetër, për veten e tyre kandidatët kanë secili të dhëna të plota dhe argumentat duhet t'i kenë më të qarta, të lidhura me faktet konkrete, atëherë unë propozoj që ta hedhim në fillim në votim këtë propozim, pra t'ua drejtojmë në formën e pyetjes, nëse ka sens kjo gjë; ose pastaj, nëse anëtarët, shumica, janë të qartë për këtë situatë juridike dhe kërkojnë që të kalojmë në votim, qoftë për kualifikim apo skualifikim, ecim. Por mendoj që duhet të vihet një radhë për të votuar se s'mund të diskutojmë në parim diçka tjetër dhe pastaj t'i hyjmë themelit të gjësë.

Ilir Toska: A mund të flasë?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, unë nuk kam asnjë vërejtje me propozimin që bën Bruna. Mundet që Këshilli, për t'u qartësuar për rrethanat faktike dhe ligjore, t'i kërkojë edhe një opinion kandidatit. I gjithë shqetësimi im ishte që në do rast, kandidati të ketë mundësi që të shprehet për do çështje që tashmë do diskutohet në Këshill dhe Këshilli, mbi atë rrethanë do duhet të marrë edhe vendimin. Ky ishte i vetmi shqetësim i imi. Kur thosha "njoftim për gjetje", doja të thosha që kandidatit mos t'i mohohet mundësia që të shprehet për një rrethanë të caktuar faktike dhe ligjore. Mundet të mos ta bëjmë në formën e gjetjes, mund ta bëjmë në formën e pyetjes, që kandidati të mund të shprehet

për këtë rrethanë faktike dhe ligjore. S'kam asnjë vërejtje.

Brunilda Kadi: Shumë mirë. Atëherë, le ta hedhim këtë në votim. Ta hedhim këtë që sapo formuloi zoti Toska, ta hedhim në votim.

Maksim Qoku: Të them diçka?

Naureda Llagami: Maksi, do flasësh?

Maksim Qoku: Po!

Maksim Qoku: Tani, unë kisha tjetër ide, por meqë e nisim nga kërkesa e Brunës për efektin e votimit të saj si propozim. Unë mendoj që ne duhet të ndalemi pak dhe të bëjmë kujdes, se nuk më duket shumë profesionale që neve t'i themi kandidatit shprehu njëherë ti për atë që pas teje do shprehemi ne. Për shembull, në aspektin e problematikës së parë që ngriti Marçela, mua më duket që në aspektin e vlerësimit kronologjik dhe historik, problemi i ndihmësgjyqtarit është zgjidhur. Siç e tha Mediu, që në '93-in, me bërjen efektiv, përvoja profesionale (jo ajo e efektit të pagesës) ka qenë e njëjtë me gjyqtarin dhe nëse mbaj mend, si bashkëkohës i atyre viteve, që të paktën kam qenë avokat në atë kohë, përveç të qenit relator, ndihmësgjyqtari më duket nuk mund të ishte relator, ai kishte të gjithë të drejtat e gjyqtarit: dilte në minorancë, mendimin e kundërt/paralel, etj., etj. Pra...

Marçela Shehu: O Maksi, më fal që po të ndërpres, por do ishte më mirë të mos diskutonim për thelbin, se po hyjmë në thelb prandaj.

Maksim Qoku: Ja po largohem.

Kështu që, unë do desha të ndajmë tani nëse ne do duhet që këtë problematikën që ngrite, ta zgjidhim sot pa e bërë kërkesën, pra të mos themi që ka ose s'ka gjetje, pikërisht për këtë debat, apo do duhet të bëjmë këtë pyetjen që thotë Bruna?! Mua më duket më e drejtë ajo problematikë që ngrite ti, që ka gjetje apo s'ka gjetje. Këtë të votojmë.

Naureda Llagami: Atëherë, e ka fjalën, Fatmira më duket.?

Fatmira Luli: Po!

Naureda Llagami: Po, Fatmira!

Fatmira Luli: Edhe unë jam me mendimin që këtë nuk duhet ta konsiderojmë gjetje dhe t'i merret mendim magistratit, për arsyen sepse ne akoma nuk kemi vendosur në lidhje me interpretimin e nenit 47, i cili përcakton në pikën 5, kushtet dhe kriteret për t'u ngritur në përgjegjësi nga radhët e gjyqtarëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte edhe bazuar edhe në vendimet që ka marrë Këshilli... Këshilli ka marrë vendimet 82 dhe 83 ku ka përcaktuar, ka cituar fjalë për fjalë interpretimin e kësaj dispozite të ligjit për Statusin e gjyqtarit. Në këto kushte, ne duhet të zgjidhim këtë moment përpara se të vendosim nëse do jetë gjetje apo jo për gjyqtarin dhe kjo nuk duhet të bëhet vetëm në lidhje me gjyqtarin {...} por për të tërë gjyqtarët e tjerë që do të kandidojnë dhe këto rregulla duhet të vlejnjë për të tërë. Ashtu si edhe rregulli tjetër për vjetërsinë specifike në fushën konkrete të së drejtës për të cilën ai do kërkojë të promovohet.

Në këto kushte unë mendoj që të vendosim rregulla. Ne kemi kërkuar mendim tek EURALIUS-i dhe tek USAID-i për gjëra fare të parëndësishme dhe ky është një moment që ne mund të kërkojmë tamam mendim të kualifikuar dhe të jetë jashtë interesave tona personale, njohje ose mosnjohje të kandidatëve. Kështu që, meqenëse bëhet fjalë për interpretim të kësaj pike të ligjit dhe nga ky interpretim varet një numër i madh kandidatësh, unë them t'i kërkojmë mendim partnerëve për interpretimin e kësaj dispozite dhe pastaj të bëjmë plotësim të vendimeve të mëparshme, për shpalljen e këtij vendi, duke përcaktuar edhe këtë kriter të detajuar, i cili do jetë i njëjtë për të gjithë kandidatët. Nuk kemi pse të flasim me emra.

Lidhur me çështjet civile, ose penale, ose specifiken, gjykoj që nuk ka nevojë të shprehemi për një numër çështjesh por minimumi, gjyqtari që ka gjykuar në ato vite, më shumë se gjysmën e çështjeve, t'i ketë të profilin për të cilin kandidon, se me numra është e vështirë të shprehesh. Kjo është ideja ime. Por gjithsesi, për të dyja këto çështje unë mendoj që është momenti që ne t'i kërkojmë mendim partnerëve. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Mund ta marr unë fjalën zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, pasi dëgjova edhe kolegët, gjithë diskutimi është në

pasoja që mund të ketë vendimmarrja sepse mund të ndodhë që kandidati të ngrejë pretendime lidhur me procedurën e verifikimit dhe të thotë që Këshilli vendosi për diçka pa më dhënë të drejtën që unë të shprehem. Prandaj, ndoshta edhe relatorja edhe Komisioni, edhe zonja Kadi e shprehu, është diskutimi që ai duhet të dëgjohet lidhur me këtë konstatim. Unë jam dakord që të mos i komunikohet gjetje, por ndoshta kandidatit t'i shtrohet kjo pyetje: Çfarë konsideroni përvojë profesionale specifike për efekt të ngritjes në detyrë, duke marrë parasysh ushtrimin e funksionit të ndihmësgjyqtarit dhe gjyqtarit? U përpoqa të bëj një formulim. Ndoshta mund të ketë formulim më të saktë. Jam dakord me propozimin e Ilirit dhe të Brunës që para se të marrim një vendim, pa u shprehur për gjetje, por që t'i japim mundësi gjyqtarit për t'u dëgjuar, t'ia ngremë në formën e pyetjes.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi dy propozime me sa kuptoj. Kemi propozimin konkret të zonjës Ukperaj lidhur me pyetjen që duhet t'i parashtrijmë fillimisht kandidatit dhe më pas të jetë objekt shqyrtimi në Këshill dhe kemi dhe propozimin e bërë nga zonja Luli, me sa kuptova, për mundësinë e një dhënieje opinioni nga ana e projekteve/partnerëve tanë këtu?

Fatmira Luli: Po! Në lidhje me dispozitat e nenit 47, pika 5 për vjetërsinë specifike 5-vjeçare; kush do të konsiderohet vjetërsi, vjetërsia e funksionit si gjyqtar apo dhe e ndihmësgjyqtar, në kuptimin që interpreton ligji, dhe të eksperiencës dhe të praktikave që ka mbajtur edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, se ka një historik. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka konsideruar për promovim për anëtarë të Këshillit vetëm gjyqtarin dhe jo ndihmësgjyqtarin. Ndërkohë që, kur është promovuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda, është gjykuar eksperiencia e tij në gjykatë. Ligji kërkonte kohën e punës së tij në gjykatë. Ka bërë vetë diferencim ligji në vende të ndryshme. Këtu kërkon eksperiencën si magjistrat. Në këto kushte, mendoj që ka nevojë për të bërë një interpretim nga partnerët.

Marçela Shehu: Mund të flas Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Unë jam dakord edhe me propozimin që bëri Bruna, Iliri, Brikena, dhe ndonjë koleg tjetër që nuk më kujtohet, pra mos t'i komunikohet si gjetje

zotit {...}, por t'i paraqitet diskutimi apo pyetja për të parë dhe qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje dhe nga ana tjetër, jam dakord edhe me atë çka propozon zonja Luli, që t'u kërkohet një mendim misioneve që na asistojnë, lidhur me interpretimin e pikës 5 të nenit 47, lidhur me përvojën profesionale specifike. Faleminderit!

Naureda Llagami: Alban, po!

Alban Toro: Në fakt, nuk do të isha dakord për të kërkuar interpretim nga partnerët sepse ky është një interpretim ligjor të cilin ne mund ta bëjmë këtu, për më tepër që një pjesë e kompozimit të Këshillit vjen nga shkalla e gjyqësorit, e cila është e aftë për ta bërë një interpretim ligjor. Bashkohem me propozimin e Brikenës apo të Ilirit për ta pyetur kandidatin në lidhje me përvojën, si e konsideron përvojën e tij specifike në komponentët ndihmës dhe gjyqtar dhe kjo besoj do të ishte e vetmja pyetje që duhet t'i adresohet atij dhe më pas të merrnim vendim duke marrë në konsideratë edhe përgjigjet që ai ka dhënë apo do të japi për këtë pyetje.

Kështu që, unë do të thosha, të hedhim në propozim këtë propozim të Brikenës dhe Ilirit dhe më pas të vijojmë të presim një përgjigje nga ana e kandidatëve. Faleminderit!

Ilir Toska: Me leje?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Erjon Muharremaj: Mundem zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Erjon, pas zotit Toska!

Ilir Toska: Atëherë, e mora fjalën vetëm për saktësim.

Unë rashë dakord me mënyrën e të proceduarit, meqenëse ma ngriti si shqetësim edhe zonja Kadi. Unë nuk kam bërë propozim konkret, thjesht jam dakord që ne mund të procedojmë në këtë mënyrë sepse s'dua të konfundohej më pas se si do votoj për rastin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, Erjon!

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Erjon Muharremaj: Kisha vetëm një reagim ndaj diskutimit të zotit Toro, i cili tha që përderisa shumica e anëtarëve të Këshillit janë gjyqtarë dhe janë të aftë të interpretojnë ligjin, shpreh mospajtimin tim me këtë qëndrim, pasi si anëtarë të Këshillit, jemi të ngarkuar, kemi marrë përsipër detyrën për të interpretuar ligjin (në cilësinë e anëtarëve), kështu që nuk pajtohemi me qëndrimin që vetëm anëtarët gjyqtarë janë të aftë të interpretojnë ligjin.

Së dyti, në lidhje me numrin e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari në fjalë, zonja Ukperaj përdori termin “do të ishte e rrezikshme” që t’i futemi kësaj analize, unë do të përdorja termin “e kundërligjshme” që t’i futemi kësaj analize, se nuk do të kishte asnjë lloj baze analizimi i numrave.

Ndërsa për çështjen e përvojës profesionale specifike unë nuk kam ndonjë dyshim, jam i qartë me mendjen time, por rikonfirmoj qëndrimin tim të përhershëm, duke iu bashkuar propozimit të zonjës Luli, për të kërkuar një mendim nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Faleminderit!

Alban Toro: Atëherë, mund të flas?

Dritan Hallunaj: Kryetare, nëse mundem?

Naureda Llagami: Faleminderit, Erjon!

Po, Alban!

Alban Toro: Erjon, është opinioni dhe opinionet nuk paragjykojnë sepse janë produkti personal i analizës së fakteve dhe fakti është që unë kam besim tek gjyqtarët. Kështu që, në këto kushte, fakti që kam besim, do të thotë që unë nuk vlerësoj pjesën tjetër jogjyqtarë sepse nga andej vij dhe do të ishte gabim trashanik nga ana ime po të bëja një fakt të tillë, por që besimin e kam të tillë dhe e konsideroj të panevojshëm, që duke pasur një kompozim që të dy palët, pra ata gjyqtarët dhe jogjyqtarët kanë njohuri të theksuar në legjislacion, të bëjnë një pyetje për interpretimin e ligjit tek dikush tjetër. Për më tepër, që në parimet e Kodit të Procedurës Civile ka një parim kryesor që thotë “gjykata e njeh ligjin”. Pra besimi është thjesht edhe duke pasur parasysh parimin që përcaktojnë kodet e procedurave, jo vetëm civilin por edhe penale. Kështu që në këtë pjesë

është opinion personal. Kërkoj ndjesë në qoftë se e kam artikuluar në një mënyrë të tillë që mund të krijojë shteg për keqinterpretime, por nuk është se unë nuk kam besim tek pjesa tjetër e kolegëve, mbivlerësoj dikë dhe nënvlerësoj dikë. Thjesht më duket i panevojshëm kërkesa për interpretim tek dikush tjetër, kur aktualisht kompozimi që kemi na lejon të bëjmë interpretime ligjore. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, fjalën e ka zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Atëherë, për sa i përket pikës së parë që thatë, për të dërguar si e interpretojnë ata këtë pikë, gjyqtarët apo kandidatët vetë, unë jam kundër. Pse? –Nuk më bën sens që t'i tregojmë/dërgojmë një gjyqtari çfarë mendimi ke ti për këtë që ne të kemi dhënë ty. Ndërsa, duke mos dashur të futem tek pjesa tjetër, në pjesën nëse një gjyqtar... pasi, mund të jetë objekt i një seance tjetër apo mund të jetë objekt i një vlerësimi përfundimtar që të themi... unë jam dakord që të njihet pjesa e punës së ndihmësgjyqtarit, pasi ashtu siç thanë edhe kolegët më sipër, ka pasur të njëjtën vlerë vota e tij, pra ndihmësit kanë nxjerrë në pakicë gjyqtarin; dhe në shumë aspekte të tjera është barazuar ajo në qoftë se kemi edhe vendimmarrje të tjera të mëparshme, është barazuar, por unë personalisht, këtë mënyrën e dërgimit që, -na jep ti mendim, -për mua nuk më bën sens. Pastaj, për pjesën tjetër thashë, do të shprehem kur të vijë momenti. Jam dakord me atë që tha Fatmira, të marrim një opinion edhe nga misionet dhe pastaj në fund, interpretimin dhe vlerësimin normalisht do ta bëjmë ne, pavarësisht se çfarë opinionit mund të kenë secili nga misionet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Hallunaj!

Atëherë, hedhim në votim dy propozimet.

Propozimi i parë ka të bëjë me dërgimin e një pyetjeje të gjithë kandidatëve, për të na dhënë një opinion lidhur me plotësimin e përvojës profesionale specifike, referuar funksioneve që kanë mbajtur gjatë karrierës së tyre si gjyqtar apo ndihmësgjyqtar.

Më pas do hedhim në votim çështjen tjetër e cila ka të bëjë me, nëse Këshilli mund t'i kërkojë për këtë çështje një mendim të specializuar Misionit EURALIUS, për

interpretimin e kësaj dispozite.

Hedhim në votim pyetjen, a jemi dakord që t'i kërkojmë një opinion kandidatit?

Maksim Qoku: Kundër, me arsyetimin që nuk më duket aspak profesionale që ne t'i drejtojmë një pyetje të kësaj natyre kandidatit konkret.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Illir Toska: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Kundër. Më duket fare e paarsyeshme të pyesësh kandidatin a duhet të konsiderohet puna ndihmësgjyqtar si eksperiencë apo jo. Është njeriu i fundit që duhet të pyetet.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër, me arsyetim pjesërisht të njëjtë me zonjën Luli që tha që duhet të jetë personi i fundit që duhet pyetur. Unë do të thosha që është e kuptueshme që qëndrimi i gjyqtarit është që ai i plotëson kriteret përderisa kandidon. Do të ishte alogjike të mendosh që dikush kandidon pa qenë i bindur që plotëson kriteret. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Pro sepse vlerësoj që është shumë e gabuar të mendosh që gjyqtari duhet të pyetet i fundit.

Medi Bici: Kundër, se kjo çështje është e zgjidhur dhe çon vetëm në vonesa.

Naureda Llagami: Kundër edhe unë.

(Propozimi i parë për t'i kërkuar opinion rrëzohet.)

Atëherë, hidhet në votim propozimin për t'i kërkuar një mendim të specializuar EURALIUS-it lidhur me interpretimin... Në fakt, ti më duket se me the për interpretimin e nenit 47, pika 5? Dhe kërkon mendim tek të dy projektet, edhe EURALIUS dhe USAID?

Fatmira Luli: Të dy projektet dhe për të dyja çështjet, edhe eksperiencia si magjistrat, se ligji thotë si magjistrat, 5 vjet; dhe fusha specifike, a duhet konsideruar gjykimi i çfarëdo lloj, a ka një numër çështjesh apo gjysma e çështjeve? Sugjerime. Kush do konsiderohet edhe eksperiencë specifike në fushën konkrete? Për të dyja çështjet.

Naureda Llagami: Okej! Faleminderit, Fatmira!

Hedhim në votim këtë.

Maksim Qoku: Kundër, edhe për këtë fakt, pasi nuk gjykoj që mbetet në specifikën e misioneve për të dhënë mendim, se nuk është tamam-tamam interpretim i atij neni, për sa ne të gjykojmë për një periudhë që është vite e mëparshme.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Kundër, për të njëjtat arsye që thashë edhe më parë.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, me shumicë votash u votua kundër faktit që të merret mendim i specializuar tek misionet.

Atëherë vazhdojmë në shqyrtimin e çështjes.

Marçela Shehu: Kryetare, i bie që të kalojmë në votimin e propozimit që ka sjellë Komisioni (relatori dhe Komisioni se çështja ka marrë qëndrimin e Komisionit), i cili konsiston në verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionin në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionin në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 83 dhe nr.85, datë 26.02.2020. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, siç e parashikon edhe rregullorja, do fillohet me votimin nga relatori, tek Komisioni dhe më pas tek të gjithë anëtarët.

Marçela Shehu: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Maksim Qoku: Kundër. Në vijim të asaj logjike që kam mbajtur edhe më parë, që përvoja specifike në frymën e ligjit, për efekt të profilizimit, i qëndron logjikës që prej 16 vjetësh e në vazhdim aktualisht kandidati është i profilizuar në fushën penale dhe do të çmoja që është një vlerë e çmuar pikërisht në këtë fushë dhe nuk do ta shikoja dot si një profilizim në fusha të tjera. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Kundër, për arsye se s'e quaj përvojë minimale edhe periudhën e punës ndihmësgjyqtar.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër. Vlerësoj që periudha e ushtrimit të funksionit të ndihmësgjyqtarit për efekt të parimeve tashmë të vendosura në karrierën e gjyqtarit duhet të konsiderohet përvojë profesionale dhe përvojë profesionale specifike, por vlerësoj që sikundër kam mbajtur qëndrimin edhe më parë lidhur me zonjën Boksi dhe zotin Kurushi, kjo përvojë profesionale është para 13 viteve, pra nuk është 13 vitet e fundit. Për këtë arsye votoj kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionin në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes

në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionin në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 83 dhe nr.85, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator – Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator – Alban Toro).

(Pas disa minutash pauzë, rifillon mbledhja plenare.)

Naureda Llagami: Atëherë, sipas rendit kemi çështjen tjetër e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, me vendime të veçanta nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, KLGJ ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile. Më pas, afati i fundit i konkurrimit të kandidatëve është mbyllur përfundimisht edhe pas periudhës së kalimit të pezullimit më datë 26.05.2020. Një nga kandidatet për këto dy pozicione ka qenë edhe gjyqtarja, zonja {...}, e cila është aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit

për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve dhe caktimin e personit Alban Toro si relator i çështjes.

Në kuadër të detyrimeve që kam, kam komunikuar me kandidaten dhe kam administruar të gjitha aktet e nevojshme të cilat do të mundësonin vlerësimin e saj për të tre kriteret e kërkuara nga ligji dhe këto kriterë përcaktohen nga neni 47, pika 5 ku magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicion nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se 13 vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse. Në këtë kuadër, janë administruar një sërë informacionesh nga disa gjykata, ku zonja {...} ka debutuar dhe ka ushtruar funksionin dhe në përfundim të së cilës ka: në lidhje me përvojën e përgjithshme, rezulton nga informacioni se {...} ka mbi 24 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, ku në të përfshihet edhe pjesa e përvojës si ndihmësgjyqtare.

Gjithashtu, në lidhje me përvojën specifike, zonja {...}, rezulton nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit se në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë, për të dyja pozicionet 85 dhe 86, të ketë një përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile si gjyqtare e shkallës së parë 3 vjet e 6 muaj e 21 ditë, si dhe si ndihmësgjyqtare për 4 vjet e 8 muaj.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit evidentohet se ajo plotësohet vetëm nëse merren në konsideratë përvoja/gjykimet në fushën e së drejtës civile dhe penale me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues si ndihmësgjyqtare.

Pra në këtë kuadër, unë do të kërkojë vëmendjen tuaj/të Këshillit sepse do të bëhet objekt diskutimi nëse duhet përfshirë kjo pjese e përvojës specifike, pra pjesa e përvojës së ushtrimit të funksionit si ndihmësgjyqtare, në identifikimin e përvojës specifike.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara më pas, në lidhje me mospasjen e masës disiplinore në fuqi, nuk është verifikuar ndonjë masë disiplinore në fuqi apo nga dokumentacioni i administruar nuk është verifikuar për kandidaten zonjën {...} të vërtetohet ndonjë situatë papajtueshmërie ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Lartë.

Kështu që, duke e plotësuar të plotë verifikimin, për kandidaten {...}, në lidhje me tre kriteret e kandidimit të ngritjes në detyrë për të dy pozicionet nr. 85 dhe nr. 86, relatori ia parashtrou rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 16.06.2020, duke e konsideruar të plotë plotësimin e verifikimit të tre kriterëve formale, ia ka përcjellë Këshillit.

Në fakt unë kam parashikuar ose kam draftuar dy drafte, një i cili mundëson vijimin e procedurës së mëtejshme dhe një për skualifikimin e kandidates {...} për përjashtimin e saj nga procedura, për shkak të mosplotësimit të kriterit të përvojës specifike, e cila, me gjasa, nëse do të miratohet nga Këshilli, do të duhet paraprakisht t'i transmetohet si gjetje dhe më pas të kalohet në një vendim të mëvonshëm në lidhje me skualifikimin e saj.

Gjithsesi, unë po jap arsyetimin ligjor mbi qëndrimin tim personal në lidhje me plotësimin e këtij kriteri pra “përvojës specifike”, e cila, siç kam relatuar dhe parashtruar në relacion rezulton se nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë për të dy pozicionet, ka një përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile si gjyqtare e shkallës së parë 3 vjet e 6 muaj, si dhe ndihmësgjyqtare për 4 vjet e 3 muaj. Pra ajo plotëson përvojën specifike duke pasur dy komponentë, komponenti i eksperiencës si ndihmësgjyqtare dhe njëkohësisht si gjyqtare.

Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese si dhe ligji në zbatim të saj, rezulton se e vetmja kategori e përzgjedhur nga sistemi gjyqësor për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë është ajo me përkatësi magjistrat, profili gjyqtar, i cili është neni 136 i Kushtetutës. Më konkretisht, në këtë përcaktohet se gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, duke parashikuar minimumin e viteve të përvojës si magjistrat, me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

Më tej ligjvënësi, në nenin 48 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve” ka përcaktuar një sistem rregullash jo vetëm për vlerësimin individual të tyre, por edhe për ngritjen në detyrë dhe e konsideron ndër të tjera ngritjen në detyrë si kalimin nga një pozicion në sistemin gjyqësor në një pozicion tjetër në nivelin më të lartë, duke përfshirë

në të edhe emërimin në Gjykatën e Lartë.

Në nenin 47, pika 5 e ligjit të sipërcituar, parashikohet se magjistrati, pra gjyqtari, mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se 13 vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën 5 vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

Pra po të shikojmë interpretimin e nenit të sipërcituar rezulton se ligjvënësi, me përdorimin e shprehjes “magjistrati, nëse ka ushtruar funksionin” indikatorin e përvojës specifike e ka lidhur me ushtrimin e funksionit të magjistratit/gjyqtarit duke përjashtuar përfshirjen e kategorive të tjera të cilat kanë gëzuar një status të ngjashëm por jo të barabartë me gjyqtarin, dhe kjo jo vetëm nga pikëpamja formale e emërimit, pasi gjyqtari emërohet me dekret të Presidentit, ndërkohë që ndihmësi me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kontratën e punës, pasi paga e tyre ndryshon, por edhe të drejtat dhe detyrimet gjatë gjykimeve procedurale civile apo penale.

Nga pikëpamja formale, ligjvënësi në përcaktimin e tij, duke vendosur për efekt të përzierjes në mënyrë të shprehur qartë (dhe këtu është mbështetur në një parim latin “in claris non fit interpretatio”) kategorinë e subjektit për t’u emëruar gjyqtar si dhe kriteret e mirëpërcaktuara për t’u plotësuar, ka synuar të evitojë keqinterpretimin e identifikimit të subjektit të cilat do duhet të përzgjidhen nga kategoria vetëm e gjyqtarëve, duke përjashtuar kategoritë e tjera që janë ndihmësit. Natyrisht, më parë ligjvënësi, për efekt të politikave të rekrutimit, kur ka dashur të përcaktojë kategori të posaçme të subjekteve të ngjashme me gjyqtarin, si për shembull ndihmësgjyqtarin, ka vendosur në legjislacion me anë të së cilës organizonte drejtësinë, dhe këtu përmend ligjin 7574, 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”, me ndryshime; ligji 8265, 18.02.1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, ligji 8436, 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, me ndryshime, ka vendosur përjashtimin apo termat të cilat lejonin përfshirjen e tyre në rekrutimin në nivele të ndryshme të gjyqësorit.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se në ndryshim nga ndihmësgjyqtarët popullorë, të cilët sipas nenit 18, të ligjit 4406, 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, këta ndihmonin në lidhjen e gjykatës me masat, në mobilizimin

e punonjësve për mënjanimin e shkaqeve dhe shkeljeve dhe në popullarizimin e ligjeve dhe vendimeve gjyqësore. Me ligjin nr. 7574, 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”, ndihmësit duhet të mbaronin Fakultetin Juridik dhe të emëroheshin me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundër ndryshimit që ka për gjyqtarin i cili vendosej me dekret të Presidentit. Më pas, me ligjin 8546, datë 05.11.1999 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8436, 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë””, kjo figurë u suprimua dhe për efekt rekrutimi u parashikua mundësia e emërimit të tyre si gjyqtar. Përfundimisht me ligjin 8601, 8602, 10.04.2000, kjo kategori e gjyqësorit u suprimua përfundimisht nga pjesëmarrja në trupat gjykues.

Pra në kushtet kur zonja {...}, provohet apo gjykimi specifik në fushën e së drejtës civile dhe penale e plotëson me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues si ndihmësgjyqtare, e cila nuk përfshihet në subjektet e përcaktuara në nenin 47, pika 5 e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, unë do të propozoja të kaloja në gjetje dhe më pas në skualifikimin e saj. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kemi donjë diskutim apo kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Kemi ndonjë diskutim?

Atëherë, të procedojmë të hedhim në votim...?

Ilir Toska: Mund të flas?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, meqenëse zoti Toro bëri diskutim sa i përket themelit, jam i detyruar edhe unë që të them disa gjëra se pse e mendoj ndryshe përvojën e ndihmësgjyqtarit në raport me përvojën e gjyqtarit, për të cilën zoti Toro mendoi që janë dy përvoja të ndryshme dhe kjo përvoja e ndihmësgjyqtarit nuk duhet të konsiderohet si përvoja e gjyqtarit për efekt të karrierës së gjyqësorit.

Atëherë, mendoj se përvoja e ndihmësgjyqtarit duhet të barazohet me përvojën e gjyqtarit, pra përvojën profesionale, pasi referuar funksionit të gjykatës (që është dhënia e

drejtësisë), të dy këto figura kanë ushtruar të njëjtën gjë, pra kanë dhënë drejtësi. Në këtë pikëpamje nuk mundet që të bëhet një mosbarazim mes figurës së gjyqtarit dhe figurës së ndihmësgjyqtarit.

E dyta, që mendoj që do duhet të konsiderohet, është që, të drejtat që kanë pasur gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari, pra sa i përket statusit të tyre, ato kanë pasur një organ emërtese qoftë për emërimin, qoftë për shkarkimin, ka qenë KLD-ja; kanë pasur të njëjtin imunitet; kanë vetëm një ndryshim, që është paga. Në ligjet e kohës thuhet që detyra e ndihmësgjyqtarit është një detyrë më e ulët se e gjyqtarit (kjo është e kuptueshme), por në raport me funksionet që ata kanë ushtruar, ato janë të njëjta. Mund të konsiderohet nga ana tjetër edhe respektimi i sigurisë juridike deri më sot, periudha e përvojës si ndihmësgjyqtar është konsideruar si përvojë e punës si gjyqtar, për efekt të karrierës së gjyqësorit. Një qëndrim i ndryshëm që ka mbajtur Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk ka të bëjë me karrierën e gjyqësorit. Përveçse është qëndrimi i një organi, i një institucioni publik, nuk është i një vendimi gjyqësor që do duhet ta mbajmë si precedent, dhe jam i mendimit që nuk është e njëjta situatë që po diskutojmë në rastin konkret. Jemi duke folur për karrierë gjyqësore, jo për emërim, zgjedhje në një detyrë, në një institucion publik, në atë rast ka qenë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Për të gjitha këto arsye, mendoj se do duhet ta konsiderojmë përvojën e ndihmësgjyqtarit, të kandidatit në rastin konkret, si përvojë profesionale të gjyqtarit, dhe mbi këtë bazë, çmoj se nuk ka vend për ta njoftuar kandidaten për gjetje, pra për një rrethanë faktike dhe ligjore që mund të çojë në skualifikimin e saj. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Erjon Muharremaj: Kisha një pyetje zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Po, Erjon!

Erjon Muharremaj: Kisha një pyetje për zotin Toro.

Përvojën profesionale të ndihmësgjyqtarit e konsideron të ndryshme nga ajo e gjyqtarit. Po përvojën profesionale të ndihmësavokatit, a e konsideron të ndryshme nga ajo e avokatit? Faleminderit!

Alban Toro: Krahasimi mendoj është i panevojshëm sepse janë dy funksione të ndryshme, si nga pjesa profesionale ashtu edhe nga pjesa e ushtrimit të funksionit, janë pa lidhje njëra me tjetrën. Ajo që unë jam munduar të evidentoj është që në nenin 4,7 pika 5, kandidati i cili kërkon të emërohet, duhet të jetë gjyqtar. Në ndryshim nga disa dispozita të cilat për efekt të inkuadrimit në gjyqësor, legjislacionet e mëparshme kanë bërë përcaktime që personi i cili duhet të kandidonte në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, duhet të punonte në gjykatë, në rastin konkret ligji ka përcaktuar që ai duhet të jetë magjistrat, pra gjyqtar. Kështu që, duke e definuar titullin magjistrat apo gjyqtar, unë them që ligji ka qenë i qartë në evidentimin e faktit që, është vetëm kjo kategori subjektsh, të cilët janë të legjitimuar për të marrë pjesë në konkurrimin e tyre në Gjykatën e Lartë. Përpos faktit që kemi goxha ndryshime, të paktë të raport edhe të figurës sepse nëse gjyqtari emërohej me dekret të Presidentit (është një institucion i pavarur), ndihmësit emëroheshin me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra pasi një gjyqtar emërohej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duhej që Presidenti, me një dekret të veçantë, ta formalizonte vullnetin e tij dhe ta integronte atë në radhët e gjyqësorit, ndërkohë që, nëse nuk e bënte këtë, ai nuk bëhej gjyqtar. Përpos kësaj, vetë ndihmësit, vetë ligji, për t'i integruar në sistem, në momentin që i suprimoi vendet, ka parashikuar ca forma dhe procedura të veçanta, si kalimin e një provimi, etj., etj., për të kaluar dhe kandiduar në rolin e gjyqtarit. Pra legjislacioni i kohës ka bërë disa diferencime të këtij karakteri dhe për mendimin tim është e qartë që në rastin konkret kërkohet figura e gjyqtarit dhe duke marrë për bazë këtë pjesë unë kërkoj përvojën e gjyqtarit në fushën civile ku është edhe pozicioni i lirë për të cilin po konkurrohet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Si procedurë, mendoj që ky diskutimi tani më duket ndoshta i ezauruar se për të njëjtin fakt ne diskutuam tek kandidati që sapo votuam dhe kam përshtypjen që secili nga anëtarët e shprehu qëndrimin e tij për interpretimin e ligjit në lidhje me këtë fakt. Kështu që, ajo që mund të diskutohet këtu mund të jetë ndonjë situatë procedurale, por për themelin dhe interpretimin e ligjit, unë mendoj se sikur s'ka vend

dhe aq më tepër, nuk e kuptova pyetjen e zotit Muharremaj për zotin Toro, kur ai u shpreh tek kandidati i mëparshëm dhe e shprehu qëndrimin e tij në lidhje me ligjin dhe nuk e kuptova lidhjen midis pyetjes që ç’lidhje ka ndihmësi me avokatin, si lidhet kjo me gjyqtarin dhe ndihmësgjyqtarin?! Po qe se ka mundësi të na i shpjegoji zoti Muharremaj lidhjen, që edhe ta ndjekim arsyetimin.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Fjalën po ia kaloj Brikenës!

Brikena Ukperaj: Në fakt, atë që do e thosha e tha Bruna.

Kështu që, edhe në vlerësimin tim është një diskutim që ne tashmë kemi vendosur, e vendosëm. Shumica vendosi që periudha e ushtrimit të funksionit si ndihmësgjyqtar duhet të konsiderohet si pjesë e përvojës profesionale për të cilën kërkon neni 48.

Dua të jap edhe unë një qëndrimin tim të shkurtër lidhur me këtë fakt.

E thashë edhe në votimin e mëparshëm, tashmë kemi një sistem të karrierës të ndërtuar për këta gjyqtarë, pavarësisht se ka qenë një organ i emërtuar ndryshe, ka qenë ai, i cili ka pasur kompetencë për të vendosur lidhur me promovimet e gjyqtarëve. Për shkak të sigurisë që duhet të ofrojë ky sistem karriere, një diskutim dhe një vendimmarrje e ndryshme do të ishte një kthim mbrapa sepse nuk bëhet fjalë vetëm për diskutimin e çështjes në parim, por bëhet edhe për diskutim nominal të çështjes sepse zonja {...} është promovuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda duke marrë parasysh përvojën profesionale edhe si ndihmësgjyqtare. Ligji i kohës parashikonte që duhet të kishte vërtet 5 vjet përvojë profesionale në gjykatë, por si gjyqtar ose si ndihmësgjyqtar dhe jo si ndonjë punonjës tjetër i gjykatës.

Për efekt të garancive që duhet të ofrojë sistemi i karrierës së gjyqtarit, referuar kauzës sociale të gjyqtarit, Kushtetutës dhe përfitimeve që gjyqtarët kanë për efekt të këtij sistemi karriere, unë vlerësoj që nuk mund të vëmë në diskutim më faktin nëse periudha e ushtrimit të funksionit si ndihmësgjyqtar duhet të vlerësohet apo jo për efekt të përvojës profesionale tashmë, që diskutojmë në lidhje me ngritjen në detyrë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ndonjë diskutim tjetër?

Erjon Muharremaj: Zonja Kryetare, më falni! Zonja Kadi kishte një pyetje që mu drejtua mua. Nëse mund t'i përgjigjem?

Naureda Llagami: Po, Erjon!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Zonja Kadi, siç e bëra të qartë në fillim të pyetjes, pyetja i drejtohej zotit Toro. Zoti Toro e kuptoi fare mirë pyetjen. Dha një përgjigje ezauruese. Kështu që, pyetja nuk ishte për juve, ishte për zotin Toro dhe unë tani jam i qartë pas përgjigjes së zotit Toro. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Më fal për ndërhyrjen. Thjesht doja ta kuptoja logjikën Erjon, që t'ju ndiqja edhe unë mbas asaj, se mbase është diçka që s'më ka shkuar mendja dhe mbi bazën e saj që do shpjegonit ju, mund të bëja edhe unë ndonjë arsyetim, se nuk e gjeta vet lidhjen midis pyetjes që bëre krahasimin midis ndihmësavokatit dhe avokatit dhe ndihmësgjyqtarit dhe gjyqtarit. Se unë vet kështu nuk e kuptova lidhjen dhe thash mbase e tregonit juve, që t'ju ndiqja në arsyetim. Përgjigjja juaj ishte ajo që ishte, kështu që, vazhdoj të mos e gjej lidhjen, por s'ka problem se nuk ka ndonjë rëndësi tani.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Atëherë, për t'u kthyer prapë tek çështja.

Mos ka ndonjë person tjetër diskutime lidhur me çështjen?

Marçela Shehu: Kryetare! Duke ndjekur të njëjtën procedurë si me kandidatin zotin Lara, unë kam propozimin, ashtu sikurse u votua edhe për zotin Lara, që mos t'i komunikohet si gjetje zonjës {...}, por t'i kërkohet mendim, t'i bëhet me dije pra trajtimi i kësaj çështjeje dhe të dëgjohet qëndrimi i saj lidhur me këtë moment. Ky është propozimi im që u votua edhe për kandidatin tjetër, zotin Lara.

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, ndonjë sugjerim tjetër përpara se të hedhim në votim propozimin e bërë?
Ndonjë propozim tjetër të lutem?

Atëherë, nëse nuk kemi propozime të tjera dhe kemi vetëm dy, propozimin e bërë nga zonja Shehu dhe zoti Toro, kalojmë në votim...

Brunilda Kadi: Më fal, Kryetare! Më fal!

Mund të ndërhyj për diçka, për të kuptuar çfarë po bëjmë.

Tek kandidati i mëparshëm...

Të vazhdoj? - se e mora fjalën dhe po vazhdoj.

Naureda Llagami: Bruna, vazhdo!

Brunilda Kadi: Për të kuptuar si do votojmë dhe çfarë do votojmë.

Nëse do vazhdojmë njësoj siç bëmë me kandidatin e mëparshëm, për pjesën procedurale, unë mendoj se ndoshta nuk ka më vend, përderisa ne për këtë fakt, për këtë interpretim të ligjit, u shprehëm njëherë tek kandidati tjetër dhe në një farë mënyre ne e dimë se si e interpretojmë gjithsecili rastin sepse bëhet fjalë për të njëjtin diskutim, për pjesën e ndihmësgjyqtarit, apo jo. Kështu që, unë personalisht që e propozova herën e parë dhe votova pro, tani në këtë moment, që ta kemi të qartë, Marçela propozon që ta pyesim kandidatin, siç u ndoq me zotin Lara.

Okej! Thjesht doja ta shprehja këtë diskutim që kam me veten time njëherë tani sepse situata është e ndryshme pasi votuam për kandidatin tjetër dhe nuk është çështje fakti, është çështje ligji. Kaq kisha. E shpreha.

Naureda Llagami: I vetmi diskutim që kemi është që kemi hyrë në një rast tjetër individual, në një procedurë tjetër dhe si e tillë, për sa kohë kemi propozime, do t'i ezaurojmë edhe votimet e këtyre propozimeve. Përveçse nëse nuk heqin dorë vet ato propozuesit. Por unë them që duhet të fillojmë tani me hedhjen në votim të dy propozimeve, të relatorit dhe të zonjës Shehu.

Maksim Qoku: A mund të na saktësohet nga zonja Shehu cila është, që të

krahasojmë edhe krahasimin e mëparshëm, se nuk po marrim vesh.

Marçela Shehu: Po! Maksi, është e njëjta procedurë, pra për kandidatin zotin Lara u propozua që ai të pyeteshe lidhur me këtë situatë ligjore dhe të njëjtin propozim, të njëjtën pyetje po parashtroj edhe për zonjën {...}.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Po fillojmë njëherë me propozimin e Marçelës, a do t'i drejtojmë pyetje zonjës {...} lidhur me përvojën e saj profesionale specifike?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër, duke pasur parasysh atë parantezën që bëra përpara se të fillonte votimi sepse tashmë unë e shpreha qëndrimin tim në lidhje me interpretimin e ligjit, për të konsideruar si përvojë profesionale kohën e ndihmësgjyqtarit tek kandidati i mëparshëm, kështu që për mua nuk ka më kuptim ta pyes kandidatin kur unë u shpreha dhe situata është identike për pjesën e interpretimit të ligjit por edhe fakti, sepse periudha që zonja {...} ka për të plotësuar 5-vjeçarin e kërkuar nga ligji është situatë e njëjtë siç e kishte edhe kandidati i mëparshëm. Kështu që unë votoj kundër për ta pyetur.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër, me të njëjtin arsyetim si në votimin e mëparshëm.

Brikena Ukperaj: Kundër sepse tashmë e kam dhënë mendimin dhe nuk ka çfarë pyetje t'i drejtojmë zonjës {...}.

(Mbledhja ndërpritet për disa minuta për shkak se lidhja me zotin Bici nuk ishte më e mundur gjatë kohës së votimit, ndaj pas disa minutash rifillon mbledhja plenare.)

Naureda Llagami: Atëherë, e kishim lënë mbledhjen tek votimi ku kishin votuar të gjithë lidhur me pyetjen e ngritur nga zonja Shehu. I fundit që duhet të votonte ishte zoti Bici, që në castin e votimit iu ndërpre interneti. Kështu që e ftoj zotin Bici të votojë

për pyetjen, nëse do t'i kërkojmë një opinion paraprak kandidates lidhur me eksperiencën profesionale specifike që ka ajo.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Atëherë, çështja e dytë që do ta hedhim në votim është propozimi i bërë nga relatori, zoti Alban Toro, në bazë të të cilit ai ngre çështjen që duhet t'i komunikojmë gjetje kandidates lidhur me eskperiencën e saj profesionale specifike si ndihmëse.

Maksim Qoku: Kundër, me të njëjtën logjikë siç e argumentova edhe më parë.

Brunilda Kadi: Kundër me arsyetim të ngjashëm me atë që votova kundër edhe për propozimin e parë. Unë tashmë e kam shprehur mendimin tim për këtë situatë ligjore, kështu që jam kundër t'ia prezantojmë si gjetje kandidates.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër, për të njëjtin arsyetim të dhënë më parë.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projekt-aktit, për propozimin...

Atëherë, Alban, duke qenë se je relatori, të bësh propozimin për kandidatin që të fillojmë edhe me votimin.

Alban Toro: Më duket Naureda, propozimi im ra. Kështu që, mbetet propozimi i Komisionit: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira

në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, votimi fillon nga Albani, më pas anëtarët e Komisionit dhe pastaj gjithë Këshilli.

Alban Toro: Kundër, për shkaqet që parashtrova më parë.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Kundër, me arsyetimin që përvoja profesionale të shikohet në aspektin e profilizimit dhe duke qenë që është i ardhur nga fusha penale, vlerësoj që nuk plotëson kushtin e kualifikimit. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Kundër, me arsyetimin që s’i plotëson kushtet minimale për eksperiencën e posaçme që kërkon ligji.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, me të njëjtin arsyetim si edhe në vendimin e mëparshëm. Përvoja profesionale 5 vjet është tej kohëzgjatjes 13-vjeçare të parashikuar në ligj.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit

në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore – Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit dhe relacionit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky relacion do të raportohet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Kandidatja zonja {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative për në Gjykatën e Lartë, të shpallur me vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të KLGJ-së.

Edhe për zonjën {...} është ndjekur e njëjta procedurë verifikimi si edhe për të gjithë kandidatët e tjerë në përputhje me ligjin dhe me vendimin nr. 75/2019 të KLGJ-së.

Janë verifikuar kriteret ligjore që lidhen me kandidimin e saj për në Gjykatën e Lartë, konkretisht përvoja e përgjithshme profesionale dhe ajo specifike në fushën e së drejtës administrative dhe civile. Është verifikuar kriteri i mospasjes të një mase disiplinore në fuqi dhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Rezulton se zonja {...} plotëson kriterin e përgjithshëm të përvojës profesionale, pasi rezulton të ketë mbi 13 vjet përvojë si gjyqtare në gjykatat më të ulëta. Gjithashtu rezulton se zonja {...} plotëson edhe kriterin e përvojës specifike në fushën e së drejtës civile dhe në atë administrative, pasi rezulton të ketë në këto fusha të së drejtës, mbi 5 vjet përvojë profesionale.

Edhe për zonjën {...}, numri i çështjeve administrative të gjykuara në raport me numrin e çështjeve civile rezulton të jetë relativisht më i ulët, por duke konsideruar edhe faktin që edhe pas diskutimeve të Këshillit nuk patëm një konkluzion ndryshe nga Këshilli për përcaktimin e përvojës profesionale specifike, rezulton që bazuar në të gjitha të dhënat, zonja {...} e plotëson edhe kriterin e “përvojës profesionale specifike” në të dy fushat e së drejtës, pra në atë civile dhe në atë administrative.

Rezulton gjithashtu që zonja {...} plotëson edhe kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, informacion ky i marrë nga dosja personale e zonjës {...}.

Rezulton gjithashtu që kandidatja plotëson edhe kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

Në këto kushte, pasi ka kaluar edhe në vlerësimin e Komisionit, i cili e ka vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit deri në këtë fazë, propozohet verifikimi i plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

Ky është edhe propozimi im si relatore dhe i Komisionit sepse me këtë propozim ka kaluar edhe nga Komisioni në Këshill. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Atëherë, nëse ne nuk kemi diskutim lidhur me përmbajtjen e relacionit dhe propozimin, mendoj se për procedurë duhet të fillojmë me votimin nga relatorja, më pas anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe më pas të gjithë anëtarët e tjerë.

Marçela Shehu: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve lidhur me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Në fakt, para se t'ia jap fjalën Komisionit propozues, dëshiroj t'ju informoj që siç jeni në dijeni, javën e kaluar kemi pasur një raportim në Kuvend për sa i përket gjendjes së sistemit të drejtësisë si dhe raportim për Këshillin. Kuptohet, një nga shqetësimet që ka parashtruar Kuvendi ka pas të bëjë me faktin e hapjes së menjëhershme të vendeve vakante në Gjykatën e Lartë. Për këtë, Kuvendi ka miratuar edhe një rezolutë, e cila me vënien dijeni në Këshill, do iu përcillet të gjithë anëtarëve, pse jo, do vlerësohet nga ana e të gjithëve ne, lidhur me detyrimet që na dalin për shkak të kësaj rezolute.

Gjithashtu, rezulton që zoti Bici kërkon fjalën për sa i përket çështjes së Gjykatës së Lartë, e ka kërkuar me shkrim që më përpara, që në fillim të rendit të ditës. Kështu që unë, fillimisht, për më shumë detaje kërkoj t'ia jap fjalën zotit Bici, se e ka diskutim parimor dhe më pas kalojmë tek Komisioni propozues.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Diskutimi im në fakt nuk kishte lidhje me çështjet e rendit të ditës, por siç e dini, ne nga Bashkimi Evropian, jemi detyruar të zbatojmë 15 detyra dhe një nga detyrat është bërja funksionale e Gjykatës së Lartë dhe e Gjykatës Kushtetuese.

Me çfarë kuptohet që ta bëjmë funksionale Gjykatën e Lartë?

Mendimi im është që edhe me tre trupa gjykues, Gjykata e Lartë është funksionale, jo me kapacitet të plotë por tre trupa gjykues funksionojnë.

Ne kemi diskutuar edhe me Komisionet, me kryetarët e Komisioneve, por edhe me Komisionin Ad Hoc por ne duhet të diskutojmë se si duhet të punojmë, duhet të punojmë të gjithë anëtarët e Këshillit (11 anëtarët); do punojmë një grup i caktuar, kryetarët e Komisioneve; se duhet të përgatisim diçka, një raport, një platformë, a udhërrëfyes (si doni t'i themi), ku të përcaktojmë disa pika dhe detyra me afate të caktuara që ne duhet t'i zbatojmë, ose aty ku ne kemi pengesa edhe organe të tjera ta mbështesin dhe të punojnë me ritmin siç po punojmë ne, siç e provoi edhe mbledhja e sotme që kanë kaluar 5 orë e gjysmë. Këtë doja të diskutoja. Sot ndoshta është një mbledhje e gjatë. Mund ta lëmë edhe nesër ose ndonjë ditë tjetër, por në një moment sa më të afërt, që ta diskutojmë.

Si do të vazhdojmë të punojmë për këtë çështje? Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Përpara se t'i jap fjalën Komisionit, kemi ndonjë diskutim apo e zhvillojmë pasi të raportohet nga ana e Komisionit?

Brunilda Kadi: Më fal Kryetare!

Ky diskutimi që ngriti zoti Bici, mbase i takon diçka që s'ka lidhje me rendin e ditës. Të mbarojmë rendin e ditës dh pastaj mund ta diskutojmë të gjithë së bashku, por jashtë mbledhjes plenare, sepse ato janë çështje të përditshmërisë sonë të punës që kanë të bëjnë me organizimin e punës tonë të përditshme. Kështu që, mendoj ta diskutojmë pasi të mbarojmë rendin e ditës. Pra jashtë mbledhjes plenare. Të gjithë siç jemi, por jashtë mbledhjes plenare, se s'është çështje e rendit të ditës, por është çështje që duhet ta diskutojmë të gjithë dhe të dalim me një ide konkrete.

Naureda Llagami: Dakord.

Kemi ndonjë sugjerim tjetër?

Medi Bici: Dakord.

Erjon Muharremaj: Edhe unë jam dakord me zonjën Kadi.

Naureda Llagami: I jap fjalën zotit Toska për të vijuar me çështjen e parafundit të rendit të ditës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime tip për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë, në fushën e së drejtës administrative, një tjetër në fushën e së drejtës civile dhe një tjetër në fushën e së drejtës penale.

Në fakt, mbledhja ishte parashikuar që të bëhesh javën e kaluar, por u shty për këtë javë. Gjithsesi, për projektvendimet tip që Komisioni ka konsideruar t'i paraqesë si propozim i Këshillit, ju është paraqitur edhe një relacion shpjegues të cilin po përpiqem ta lexoj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, më datë 26.02.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 84, si dhe për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87.

Në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë numrin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë që mund të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, konkretisht 14 (katërmëdhjetë).

Më tej, Këshilli ka mbajtur parasysh se ka përgjegjësinë kushtetuese për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), që e zbatuar në realitetin që sistemi gjyqësor gjendet, aktualisht do të duhet të konsiderojë jo vetëm bërjen funksionale të Gjykatës së Lartë, por edhe moscenimin e funksionalitetit të gjykatave të tjera nga prej gjyqtarët do të ngrihen në detyrë në këtë gjykatë.

Po ashtu, Këshilli ka mbajtur parasysh edhe frymën e ligjit, që konsideron ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës së Lartë rast pas rasti dhe jo tërësore të saj, për sa kohë nuk jemi para ngritjes së saj rishtazi.

Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur parasysh edhe qëllimin e tij strategjik për rikthimin sa më parë të funksionalitetit të plotë të Gjykatës së Lartë, gjë e cila mund të arrihet vetëm përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Nga ana tjetër, në këtë rast, Këshilli ka vlerësuar se hapja e menjëhershme e procedurave për të gjitha pozicionet e lira mbarte disa problematika dhe risqe, të cilat mund të çonin në mosarritjen e objektivit final brenda një kohe optimale.

Konkretisht, Këshilli ka mbajtur parasysh se ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit, do të duhet të kalojë edhe përmes procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve. Këshilli ka vlerësuar se ky proces është përgjegjësi e tij, por marrë shkas nga rrethi i kandidatëve të mundshëm aktualisht, të cilët që të gjithë janë subjekt rivlerësimi sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar dhe Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, ky proces patjetër që do të interferonte me procesin e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve, pra rivlerësimin e tyre me prioritet nga organet e rivlerësimit. Këshilli ka konstatuar se kishte një numër shumë të vogël gjyqtarësh që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka do të thoshte që rrethi i kandidatëve potencialë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë ishte i kufizuar. Konkretisht, më datë 26.02.2020, ka pasur 14 (katërbëdhjetë) gjyqtarë (një gjyqtar i shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; katër gjyqtarë të shkallës së parë të juridiksionit administrativ, dy gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të posaçëm për krimin e organizuar dhe korrupsionin; dy gjyqtarë të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe pesë gjyqtarë të gjykatës së apelit të juridiksionit të posaçëm për krimin e organizuar dhe korrupsionin) që kishin kaluar me sukses, me vendim përfundimtar, procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që plotësonin kriteret e ligjit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, pra 14 (katërbëdhjetë) kandidatë potencialë.

Në vijim, Këshilli ka mbajtur parasysh se ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit, është e lidhur edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, sikundër dhe me procesin e renditjes së tyre, procese këto që

do të zbatoheshin për herë të parë nga Këshilli, rrethanë kjo që vlente të mbahej në konsideratë në raport me operativitetin e Këshillit.

Mbi sa më lart, Këshilli konsideroi zbatimin e një skeme që merrte parasysh këto rrethana, ndërsa përmes afateve të ndryshme të kandidimit për secilin nga tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe asaj civile, mund të supozohej se, me vijimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, rrethi i kandidatëve potencialë të rritej, çka do t'iu jepte kohë dhe mundësi për të kandiduar çdo gjyqtari që aspironte për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për pasojë do të rriteshin mundësitë për përzgjedhjen e kandidatëve cilësorë për promovim në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor, çka, përveç se legjitime, është dhe një obligim ligjor për Këshillin. Po ashtu, Këshilli ka vlerësuar se një mënyrë e tillë të proceduari do të rriste mundësitë e tij për të përfunduar në një kohë sa më të shpejtë procedurat e veçanta të ngritjes në detyrë për çdo pozicion të lirë, pra do të bënte më të zhdërvjellëta këto procedura dhe, në këtë mënyrë, do të rritej funksionaliteti i Gjykatës së Lartë brenda të njëjtës periudhë kohore.

Nga ana tjetër, Këshilli ka gjykuar se hapja e menjëhershme e procedurave për të gjitha pozicionet e lira, si dhe vendosja e një afati të shkurtër kohor për kandidim, ishte e mundur që të çonte në dy situata. Në situatën e parë që mund të supozohet, do të kishte një numër të vogël kandidimesh, vetëm nga gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka jo vetëm kufizonte mundësinë e përzgjedhjes së kandidaturave më të mira, por mund të perceptohej edhe si proces i paracaktuar. Në situatën e dytë të supozuar, do të kishte një numër të lartë kandidaturash, çka patjetër do të çonte në bllokimin e procedurave të ngritjes në detyrë për një kohë të gjatë, varësisht nga përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar për të gjithë kandidatët, sikundër edhe të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të tyre.

Po ashtu, Këshilli ka vlerësuar se, në varësi të indikacioneve që do të rezultonin nga procedurat e ndjekura për gjashtë pozicionet e lira si më lart, ai mund të konsideronte hapjen në kohë edhe të procedurave të tjera të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të mbetura për secilën nga dy fushat e të drejtës, atë administrative dhe civile, për të kompletuar kështu numrin maksimal të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në këto fusha.

Ndërsa sa i përkiste hapjes së procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në fushën e të drejtës penale, Këshilli ka gjykuar që ato

të hapeshin në një moment të dytë, kur praktikisht të kishte kandidatë potencialë të mjaftueshëm për ngritjen në detyrë, si dhe kur organizimi i këtyre procedurave të mos sillte implikime të rënda në mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor. Për këtë, Këshilli ka pasur parasysh se për shkak të trajtimit me prioritet të procesit të rivlerësimit kalimtar për gjyqtarët e ish-gjykatave për krimet e rënda (sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar), ndërsa për një pjesë të gjyqtarët e këtyre gjykatave ky proces kishte mbaruar pozitivisht me vendim përfundimtar, ndërkohë që ata kishin një përvojë të gjatë në fushën e të drejtës penale, potencialisht ata do të ishin kandidatë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në fushën e të drejtës penale. Një gjë e tillë, në supozimin e daljes së tyre fitues në garën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, do të sillte implikime për funksionalitetin e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat që në momentin e fillimit të funksionimit, më datë 19.12.2019, kanë pasur dhe vijnë të kenë më pak gjyqtarë në detyrë se numri minimal i përcaktuar nga ligji (neni 4 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”). Për këtë shkak, për të cilën nga gjykatat e posaçme, më datë 26.02.2020, Këshilli konsideroi hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë për 10 pozicione të lira (nga pesë për secilën nga ato), ndërkohë që për një pjesë të gjyqtarëve të gjykatës së posaçme të shkallës së parë (për tre gjyqtarë) vijon akoma procesi i rivlerësimit kalimtar.

Mbi sa më lart, në varësi të indikacioneve që do të rezultonin nga procedurat e filluara të ngritjes në detyrë, Këshilli ka gjykuar se do të konsideronte hapjen në kohë edhe të procedurave të tjera të ngritjes në detyrë për 8 pozicionet e të lira që kanë mbetur, për të kompletuar në këtë mënyrë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Vlen të përmendet se, pas përfundimit të afatit të pezulluar dhe më pas të zgjatur të kandidimit për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, më datë 29 prill 2020, për dy pozicionet e para të lira në secilën fushë të së drejtës (administrative dhe civile) dhe më datë 26 maj 2020, për dy pozicionet e dyta të lira në secilën nga këto dy fusha të së drejtës, kandiduan gjithsej 12 (dymbëdhjetë) kandidatë, nga të cilët 10 (dhjetë) kanë kaluar me sukses me vendim përfundimtar procesin e rivlerësimit kalimtar, 1 (një) tjetër ka qenë dhe vijon të jetë prej më shumë se një viti nën këtë proces, si dhe 1 (një) tjetër

për të cilin ky proces sapo ka filluar me prioritet pas kërkesës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për dy pozicionet e fundit të lira në secilën fushë të së drejtës (administrative dhe civile), për të cilat afati i kandidimit mbaron më datë 30 korrik 2020, ka edhe një kandidat tjetër, për të cilin procesi i rivlerësimit vijon prej më shumë se një vit.

Ndërkohë, nga kandidimet e deritanishme konstatohet se kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë 4 gjyqtarë të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Po ashtu, për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konstatohet se vetëm për një pozicion të lirë, ka kandiduar një gjyqtar, për të cilin, mbi kërkesën e Këshillit, në maj 2020 ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar me prioritet, ndërsa për katër pozicionet e tjera të lira nuk kandidoi asnjë gjyqtar, gjë e cila ndodhi edhe pas rihapjes së procedurës së ngritjes në detyrë për tre pozicione. Aktualisht, në këtë gjykatë është shtuar edhe një pozicion tjetër i lirë, për shkak të shkarkimit nga detyra të një gjyqtari në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për pesë pozicionet e lira në këtë gjykatë është propozuar dhe Këshilli pak më herët miratoi hapjen përsëri të procedurave të ngritjes në detyrë. Momentalisht, në këtë gjykatë janë në detyrë dhjetë gjyqtarë, nga të cilët: - për katër gjyqtarë ka përfunduar me sukses me vendim përfundimtar procesi i rivlerësimit kalimtar dhe ata kanë kandiduar për në Gjykatën e Lartë (njëri prej tyre) dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (tre prej tyre); - për tre gjyqtarë të tjerë ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar përpara KPK-së, për një nga të cilët është paraqitur ankimi nga Komisioneri Publik, ndërsa për dy të tjerët pritet publikimi i vendimeve për të mësuar më pas nëse procesi do të përfundojë apo do të vijojë përpara KPA-së; - për tre gjyqtarë procesi vijon prej gati një viti e gjysmë.

Për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konstatohet se për tre pozicione të lira kandiduan tre gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa për pozicionin e katërt të lirë kandidoi vetëm një gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, për të cilin, mbi kërkesën e Këshillit, në qershor 2020 ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar me prioritet. Për pozicionin e pestë nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Aktualisht, në këtë gjykatë është shtuar edhe një pozicion tjetër i lirë, për shkak të shkarkimit nga detyra të një gjyqtari në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për dy pozicionet e lira në këtë gjykatë është propozuar dhe Këshilli më herët miratoi hapjen përsëri e procedurave të ngritjes në detyrë. Momentalisht, në këtë gjykatë janë në detyrë pesë gjyqtarë, për të cilët ka përfunduar me sukses me vendim përfundimtar procesi i rivlerësimit kalimtar, ndërsa deri më sot, tre nga të cilët kanë kandiduar për në Gjykatën e Lartë.

Në situatën aktuale, ndërsa procesi i rivlerësimit kalimtar ka vijuar, ndërkohë që Këshilli Evropian më datë 25 mars 2020 vendosi hapjen e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë, ku mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare është kushtëzuar, ndër të tjera, edhe me sigurimin e funksionimit të Gjykatës së Lartë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira që duhet të plotësohen nga radhët e gjyqtarëve, duke përgatitur për këtë tre projektvendime tip për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicione të lira në të tre fushat e të drejtës, pra atë administrative, civile dhe penale.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi se është Këshilli ai që, në varësi të rrethanave dhe të përgjegjësive të tij, duhet të vendosë për numrin e pozicioneve të lira për të cilat duhet të hapen procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, sikundër dhe për afatet e kandidimit në lidhje me to.

Gjithsesi, duke vlerësuar se numri i gjyqtarëve me përvojë specifike duhet të jetë i barabartë për të tre fushat e të drejtës, çka do të mundësonte funksionimin normal të të tre Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerësoi të sjellë në vëmendje të Këshillit disa të dhëna që mbetet të mbahen parasysht në lidhje me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Konkretisht, në Gjykatën e Lartë sapo janë emëruar tre gjyqtarë nga radhët e juristëve të spikatur, ku secili prej tyre ka përvojë specifike në njërin nga tre fushat e të drejtës. Pra, për secilën fushë të së drejtës sot në Gjykatën e Lartë ka një gjyqtar.

Më tej, Këshilli është në proces për plotësimin e Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, edhe të një pozicioni të lirë në fushën e të drejtës civile. Pra, në

potencë, në Gjykatën e Lartë do të ketë edhe një gjyqtar tjetër me përvojë specifike në fushën e të drejtës civile.

Së fundi, sikundër dhe më lart u parashtrua, Këshilli është në proces për plotësimin e Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, edhe të gjashtë pozicioneve të lira, tre në fushën e të drejtës administrative dhe tre në fushën e të drejtës civile. Pra, në potencë, në Gjykatën e Lartë do të ketë edhe tre gjyqtarë të tjerë me përvojë specifike në fushën e të drejtës administrative, si dhe tre gjyqtarë të tjerë me përvojë specifike në fushën e të drejtës civile.

Pra, në rast të finalizimit me sukses të të shtatë procedurave të ngritjes në detyrë që janë në proces, në Gjykatën e Lartë do të ketë katër gjyqtarë me përvojë specifike në fushën e të drejtës administrative, pesë gjyqtarë me përvojë specifike në fushën e të drejtës civile dhe një gjyqtar me përvojë specifike në fushën e të drejtës penale.

Duke mbajtur parasysh numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, pra nëntëmbëdhjetë, për të pasur një numër të njëjtë gjyqtarësh me përvojë specifike në secilën nga tre fushat e së drejtës, duhet që ky numër të jetë gjashtë për secilën fushë.

Nisur nga sa më lart, në vlerësim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, tetë pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, për të cilat mund të hapen procedurat e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve, duhet të jenë si vijon:

- 1) dy pozicione në fushën e të drejtës administrative;
- 2) një pozicion në fushën e të drejtës civile;
- 3) pesë pozicione në fushën e të drejtës penale.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve tip për çdo pozicion të lirë në secilën nga tre fushat e së drejtës, ato janë strukturuar në 4 Krerë, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e hapjes së gjashtë procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, sipas Vendimeve nr.82-87, datë 26.02.2020, me ndryshimin sa i përket përvojës specifike sipas fushave të së drejtës.

Bashkëlidhur projektvendimeve tip janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari -

Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, do të ftoja të gjithë kolegët për diskutim.

Brunilda Kadi: Mund të them unë diçka? Të marr fjalën?

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Atëherë, në lidhje me diskutimin që parashtron para Këshillit Komisioni, unë thjesht shkurtimisht të shpreh mendimin tim.

Atëherë, përpara se ne të merrnim vendimin për shpalljen e 6 vendeve vakante para disa muajsh, siç e dimë të gjithë, tre për administrative dhe tre civile, në diskutimet paraprake që ne kemi bërë me njëri-tjetrin në Këshill, unë kam pasur mendimin fillimisht që duhet t'i hapim të gjitha vendet, për të gjitha ato arsyet formale që i dinë të gjithë.

Mbas diskutimeve me njëri-tjetrin dhe relacionit që bëri Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mua mu dukën me kuptim dhe të pranushme të gjitha arsyet pse bëmë atë zgjedhje dhe kam votuar 'Pro'.

Ndërkohë, nisur nga situata faktike çfarë pamë me këto hapje vendesh dhe si ishte situata e kandidimit, mendoj se tani ndoshta do jetë më e arsyeshmja, përveçse edhe e ligjshme që ne t'i shpallim të gjitha vendet sepse ndoshta ngurrimi i magjistratëve për të kandiduar, të gjithë e pranojmë që ka lidhje me procesin e vettingut, por nëse tani ata ngurrojnë dhe kanë një arsye sepse mendojnë që në një moment të dytë do kenë mundësi të kandidojnë duke ditur që potencialisht janë edhe disa vende të tjera vakante që do të hapen në të ardhmen, duke i shpallur të gjitha sot çfarë janë potencialisht vakant, ata nuk do ta kenë më këtë argument me veten e tyre dhe ata që kanë për të kandiduar dhe mendojnë që ia vlen që të futen në këtë garë do ta vendosin dhe do vijnë. Sepse arsyet pse duhet të hapen të gjitha, nuk ka nevojë që t'i përmendim, e dimë dhe biem dakord të gjithë. Por mendoj që edhe arsyet praktike dhe gjithë ai arsyetimi në lidhje me cilësinë, dhënien e mundësisë të gjithë magjistratëve, që të kenë mundësi të promovohen dhe të zhvillojnë karrierën e tyre, qëndrojnë, por nga e gjithë situata, unë sot, arrij në

konkluzionin që ne duhet t'i hapim të gjitha vendet që janë në dispozicion dhe kushdo nga magjistratët që mendon se vlen dhe jep kontributin për atë pozicion, le të vijë tani të kandidojë.

Në qoftë se procesi i vettingut është një proces i vështirë dhe askush ndoshta nuk do të donte të hynte vullnetarisht me prioritet, në fund të fundit të gjithë e kanë për ta kaluar, siç e kanë kaluar ata që e kanë kaluar. Kështu që, mendoj që është momenti tani të gjithë ta marrim këtë vendim dhe të ecim sepse nuk mund të pritët më. Pra, përfundimisht mendoj që duhet të hapen të gjitha vendet.

Ndërsa, për ndarjen se si duhet të bëhet, ky është një moment i dytë. Në qoftë se Këshilli me shumicë vendos që duhet të hapen të gjitha vendet, pastaj ky është një moment i dytë se si unë mendoj në lidhje me fushat, se si duhet të ndahen pozicionet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Bruna!

Ndonjë koleg tjetër?

Brunilda Kadi: Kryetare, më fal që po ndërhyj prapë.

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Në qoftë se nuk ka të tjerë që të diskutojnë, mbase hedhim në votim këtë, le ta quajmë propozim nga ana ime, për t'u hapur të gjitha vendet.

Naureda Llagami: Po prisja nëse ndonjë koleg ka mendim ndryshe.

Brunilda Kadi: Patjetër! Patjetër! Por nëse askush nuk ka ndonjë gjë për të thënë, mbase kalojmë në votim.

Marçela Shehu: Mund të flas unë Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Unë bashkohem me Brunën lidhur me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve, për të gjitha pozicionet e lira të mbetura. Do doja vetëm të bëja një ndarje që lidhet me afatin e shpalljes së këtyre pozicioneve. Unë do propozoja që 4

pozicione në fushën e së drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative të kishin një afat për paraqitjen e kandidaturave më të shkurtër, krahasimisht me tre pozicionet e tjera që do të mbeteshin për një afat më të gjatë.

Pse e bëj këtë ndarje? – Duke u bazuar tek pozicionet që kemi shpallur deri tani, si dhe duke konsideruar edhe parashikimet ligjore që rregullojnë funksionimin e Gjykatës së Lartë, të kolegjeve dhe të trupave gjykues, ne na rezulton që deri tani, kemi aktualisht në Gjykatën e Lartë një gjyqtar që lidhet me fushën e së drejtës administrative, ndërkohë kemi në proces procedurat për tre pozicione të fushës administrative që lidhen me kandidatët nga radhët e gjyqtarëve. Ndërkohë, kemi të emëruar një gjyqtar që lidhet me fushën e së drejtës civile tashmë në Gjykatën e Lartë, kemi në procedurë verifikimi një kandidat që vjen nga radhët e jogjyqtarëve por që lidhet me fushën e së drejtës civile dhe ndërkohë, kemi në proces verifikimi nga radhët e gjyqtarëve, tre pozicione të tjera. Pra, në total, pritshmëria është që numri i gjyqtarëve në fushën e së drejtës administrative në Gjykatën e Lartë të shkojë 4 (deri në këto momente), në fushën e së drejtës civile të shkojë 5 numri, ndërkohë që në Gjykatën e Lartë, lidhur me pozicionin që lidhet me fushën e së drejtës penale, aktualisht kemi vetëm 1 gjyqtar që ushtron detyrën dhe ndërkohë nuk kemi shpallur asnjë pozicion që lidhet me fushën e së drejtës penale.

Mendoj që 4 pozicionet në fushën e së drejtës penale dhe 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative janë më urgjente krahasimisht me 3 pozicionet e tjera, për sa i përket afatit, duke pasur parasysh që çështjet penale në Gjykatën e Lartë gjykohen me trupa gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, por çështjet penale e gjykuara nga gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar gjykohen nga një trup gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë. Ndërsa pika 4 e nenit 31 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, parashikon që çështjet administrative gjykohen nga Gjykata e Lartë me trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtarë, por çështjet që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore, trupat gjykues përbëhen nga 5 gjyqtarë.

Duke shpallur thirrjen për plotësimin e Gjykatës së Lartë me 4 pozicione në fushën e së drejtës penale, 1 pozicion në fushën e së drejtës administrative, me një afat deri në fund të korrikut, ne e kemi pothuajse tërësisht funksionale Gjykatën e Lartë lidhur me përbërjen e të gjithë trupave gjykues që gjykojnë çështjet penale, civile dhe administrative. 3 pozicionet e tjera që mbeten, që në vlerësimin tim duhet t'i

korrespondojnë një fushe të caktuar, pra nëse mbesin 3 pozicione nga radhët e gjyqtarëve, unë vlerësoj që 1 pozicion duhet të jetë i fushës civile, 1 i fushës administrative dhe 1 i fushës penale, duke krijuar edhe barazi në ndarjen e gjyqtarëve sipas fushave, por nga ana tjetër, duke krijuar edhe mundësinë e krijimit të dy trupave gjykues në Gjykatën e Lartë. Pra me këtë formatim ne do të kemi 18 gjyqtarë, përveç gjyqtarit që është anëtari i Këshillit, të ndarë 6 gjyqtarë në të treja fushat dhe për çdo fushë do të kemi trupa gjykues.

Nuk e di nëse isha e qartë. Për ta përmbledhur edhe një herë propozimin tim konkret, unë parimisht jam për shpalljen e të gjitha procedurave, por jam për shpalljen e 4 pozicioneve në fushën e së drejtës penale dhe 1 në fushën e së drejtës administrative me një afat më të shkurtër, deri në fund të korrikut të këtij viti, ndërkohë që për tre pozicionet e tjera, 1 në fushën administrative, 1 në penale dhe 1 në civile, ky afat mund të jetë më i gjatë, unë propozoj deri në fund të tetorit, me qëllim për t'i dhënë mundësi edhe procesit të rivlerësimit që të avancojë dhe zgjerimit të rrethit të gjyqtarëve të interesuar për të kandiduar për një pozicion për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Marçela për propozimin.

Ndërkohë fjalën e kërkon zoti Bici.

Medi Bici: Zonja Marçela i tha drejt përgjithësisht ato çka tha, por dua të vë në dukje se për çështjet penale Gjykata e Lartë punon me trup gjykues vetëm me 5 gjyqtarë, në dhomë këshillimi. Por ajo që është më emergjente në Gjykatë të Lartë, mendimi im është se duhet dhënë përparësi fillimisht kolegjit civil, pastaj kolegjit administrativ. Kolegji civil ka dyfishin e çështjeve dhe Gjykata e Lartë, sa për dijeni funksionon me një listë gatishmërie. Ne themi që do shkojmë tek juristët e specializuar, por do të ketë gjithmonë mundësi që gjyqtarët e kolegjit civil dhe gjyqtarët e kolegjit administrativ të zëvendësojnë gjyqtarët e kolegjit penal dhe anasjelltas, se nuk bëhet ndryshe. Në Gjykatë të Lartë, gjithmonë dy gjyqtarë ishin të gatshëm, çdo javë. Kaq kisha.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Ndonjë diskutim tjetër?

Po, zonja Ukperaj fjalën.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Atëherë, në vlerësimin tim është prioritarë për Këshillin rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë. Ky rifunksionalizim nuk do të thotë vetëm plotësim i numrit të gjyqtarëve, por funksionalizim edhe me strukturë administrative dhe mbështetëse, këshilltarë ligjorë, punonjës së administratës, etj.

Lidhur me numrin e gjyqtarëve, për të cilët sot ka pozicione të lira vakante, janë 8 pozicione të tilla. Në vlerësimin tim nuk ka ndryshuar asnjë gjë nga gjendja sikundër ishte në datën 26.02.2020 kur ne shpallëm vetëm 6 prej tyre, pra, për të mos i përmendur argumentat e zotit Toska, mbetem në të njëjtën situatë, ku kemi një numër shumë të reduktuar gjyqtarësh që kanë kaluar procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë, nga të cilët, nëse kishim 14, sot kemi 18, referuar dhe të dhënave që i bashkëlidhen relacionit.

Sigurisht që nuk është kusht i parashikuar në ligj që gjyqtari që kandidon për Gjykatën e Lartë duhet ta ketë kaluar me vendim të formës së prerë, por me aktin nënligjor ne kemi pranuar që të mos kemi konkurrim të dy procedurave njëkohësisht të verifikimit të pasurisë, do duhet që organet e rivlerësimit, për kandidatët që aplikojnë për Gjykatën e Lartë të mbarojnë procedurat e vlerësimit brenda një afati 3-mujor dhe në të kundërt ne do vijojmë.

Dua të sjell në konsideratë edhe opinionin e Komisionit të Venecias për qëndrimin që ka mbajtur lidhur me Gjykatën Kushtetuese, ku është lënë si detyrë rikonsiderimi i faktit që të gjithë gjyqtarët që do shkojnë në Gjykatën Kushtetuese duhet ta kenë mbaruar procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë. Në vlerësimin tim personal, kjo duhet të ndodhë në fakt edhe për Gjykatën e Lartë sepse nuk do të kishte sens që ne të promovonim një gjyqtar dhe të kishim një rezultat negativ nga organet e rivlerësimit dhe unë nuk do të doja që të ndodhte kjo gjë.

Është fakt i njohur dhe i pranuar që procesi i rivlerësimit ka ndikuar në stepje të gjyqtarëve për të kandiduar në Gjykatën e Lartë, për shkak të vështirësisë që ka ky proces dhe nga ana tjetër, duke pasur një numër të kufizuar gjyqtarësh, shumicën e tyre e kemi nga gjykatat speciale për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Një nga arsyet që ne nuk shpallëm pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, ka qenë pikërisht edhe kjo, do të prishnim funksionalizimin e SPAK-ut sepse tendenca ishte që gjyqtarët që kishin kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit, ishin pikërisht këta gjyqtarë, për shkak edhe të nevojës që kishte ngritja e kësaj strukture. Në të njëjtat kushte jemi edhe sot, madje kemi një numër më të reduktuar gjyqtarësh në këto gjykata.

Duke analizuar të gjitha këto situata, duke marrë parasysh që rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë nuk do të thotë që në mënyrë të menjëhershme të plotësohen të 18 vakancat, duke marrë parasysh vakancën e z. Bici; duke marrë parasysh që për të funksionuar si organ emërtese, Gjykata e Lartë duhet të ketë 15 gjyqtarë dhe për të mbledhur në Kolegjet e Bashkuara 13 ose 12 gjyqtarë, në vlerësimin tim, për të garantuar edhe mbarëvajtjen e sistemit, do të ishte më proporcionale shpallja e vetëm 5 vendeve vakante, me përfundim të afatit të kandidimit deri në fund të muajit korrik. Këto 5 vende vakante, jam dakord me propozimin e zonjës Shehu, të jenë 4 vende në fushën penale dhe 1 vend në fushën administrative, për të garantuar që të kemi një kolegji prej 5 gjyqtarësh të specializuar në fushat përkatëse.

Duhet patjetër sepse ajo që na ka ndodhur në fakt, kemi parë edhe vet që gjyqtarët e specializuar në fushën penale, po kandidojnë në fushën civile ose në fushën administrative. Kështu që edhe këtyre gjyqtarëve, ndoshta duke iu dhënë mundësia, marrë parasysh edhe qëndrimin e sotëm që nuk mund të kandidojnë në më shumë se tre pozicione të lira, të aplikojnë për pozicionin ku ata mund të japin maksimumin.

Për 3 pozicionet, mendoj që Këshilli ta rivlerësojë situatën në një të ardhme shumë të afërt, ndoshta mund të ndodhi në muajin shtator dhe muajin tetor sepse këto 3 pozicione janë të lidhura ngusht me trendin e gjykimeve në Gjykatën e Lartë. Unë jam dakord me atë që thotë zoti Bici. Sot mbi 18 mijë të çështjeve i përkasin të drejtës civile, mbi 12 mijë të drejtës administrative dhe më pak se 1/3 e çështjeve civile janë çështje penale (rreth 5 mijë çështje penale). Kështu që duhet një rivlerësim i situatës për të shpallur pozicionin konkret në të cilin duhet të shkojnë këta tre gjyqtarë në 3 pozicionet e tjera të mbetura. Duhet të bëhet një studim i ngarkesës së gjykatës, pra sa çështje ka sot gjykata dhe i trendit se si kanë ecur gjykimet deri tani vetëm me trupën prej 3 gjyqtarësh.

Propozimi im është që të shpallim vetëm 5 vende vakante, 4 penale dhe 1 administrativ, me afat të përfundimit të kandidimit në muajin korrik dhe pastaj të rivlerësojmë situatën në muajin shtator për të shkuar në një propozim tjetër, ndoshta në muajin tetor, lidhur me 3 pozicionet e tilla.

Pse nuk jam dakord që t'i shpallim të gjitha dhe duke lënë edhe afatin më të gjatë?

Nuk dua ta pranoj por ndoshta kjo do të sjellë një perceptim që kandidatët do të na i përcaktojnë strukturat e rivlerësimit pastaj se kush do kalojnë përpara vettingun dhe do aplikojë. Në vlerësimin tim, kjo nuk duhet të ndodhë, prandaj mendoj që do të ishte, edhe për të garantuar funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, për të mbajtur edhe gjykatat e shkallëve të tjera në funksion, të vazhdonim me një procedurë graduale të plotësimit të vendeve vakante, sipas kësaj që unë propozoj. Faleminderit!

Maksim Qoku: Kryetare!

Të them diçka?

Naureda Llagami: Po, Maksi!

Maksim Qoku: Për të mos u zgjatur në argumente.

Unë në fakt jam dakord me logjikën e Marçelës dhe të Brikenës. Realisht ashtu është, ne arrijmë së pari mirëadministrimin e sistemit dhe nuk bëhemi pengesë për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, duke miratuar 4 vende për fushën penale dhe 1 për atë administrative, dhe vetëm për të shtuar së fundi, tek pjesa e 3 vendeve që ne mund t'i mbajmë rezervë për shpallje dhe ndërkohë që kemi arritur funksionalitetin është fakti që nga njëra anë edhe ne bëjmë një ndjekje të kujdesshme të realizimit të gjykimit të çështjeve duke kontrolluar backlog-un dhe kjo pastaj, në një periudhë të dytë, mbase nga shtatori, do na mundësonte që të ndajmë pozicionimin e këtyre 3 vendeve në njërin nga fushat specifike. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Maksi!

Ndonjë propozim tjetër?

Kemi propozime të tjera?

Alban Toro: A mund të flas?

Naureda Llagami: Po, Alban!

Alban Toro: Atëherë, po shpreh një opinion fillestar në lidhje me atë pamje që pamë nga ekrani i televizorit, në lidhje me qëndrimin e disa përfaqësuesve të Kuvendit në raport me një organ kushtetues, siç është KLGJ-ja. Ishte një qëndrim që në opinionin tim ka cenuar pavarësinë e institucionit, për më tepër reagimi inaktiv i Kryetares ndaj këtij qëndrimi është më alarmante në këtë pjesë.

Gjithsesi, për të mos humbur kohë shumë për qëndrimin jo vetëm në atë sallë por edhe në disa komisione të veçanta, më duhet të ndalem pak tek pjesa e hapjes së vendeve. Shqetësimi i KZHK-së ka qenë gjithmonë prezent për hapjen e vendeve të Gjykatës së Lartë dhe partnerët tanë kanë rekomanduar fuqimisht që vendet duhet të hapen në mënyrë graduale, kjo edhe për faktin sepse passjell rrezik që disa gjykata të tjera të mbyllen nga konkurrimi që mund të bëjnë gjyqtarë të caktuar, siç është gjykata e posaçme dhe siç aktualisht po tregohet që një pjesë e tyre po konkurrojnë në Gjykatën e Lartë. Pra do ndodhemi në alternativën që nesër do na duhet t'i gjejmë zgjidhje se kë duhet të çojmë në gjykatën e apelit. Kështu që, në këtë kuadër, ndoshta do të ishte mirë që të pyesim paraprakisht partnerët tanë, siç pyesim për interpretimin e ligjit, në mënyrë të veçantë EURALIUS-in, të pyesim nëse parashikohet, kush janë skenarët më të këqinj të mundshëm të hapjes së gjithë vendeve në Gjykatën e Lartë, duke marrë në konsideratë edhe mbylljen e ndonjë gjykate tjetër specifike, -në mënyrë që të jemi të përgatitur për të gjithë skenarët. Nëse do të hapim në Gjykatën e Lartë, do të marrim në konsideratë që t'i përgjigjemi edhe emergjencës së mbylljes të ndonjë gjykate të posaçme.

Kështu që, në këtë kontekst, do të ishte më mirë që para se të marrim një vendimmarrje që do të mundësonte hapjen e të gjithë vendeve, të pyesim partnerët nëse janë... dhe shikojmë skenarët për mbyllje gjykatash. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Thjesht për replikë për sa i përket inaktivitetit të Kryetares në Kuvend. Kuvendi i Shqipërisë ka një protokoll të mënyrës së raportimit. Ju ftoj që ta shihni dhe ta konsultoni. Në momentin që unë raportoj, pra çdo institucion i pavarur raporton, nuk ka më pyetje dhe nuk i lejohet raportuesit të ketë diskutime dhe pyetje përveçse nëse deputetët kanë pyetje sqaruese.

Lidhur me deklaratat që bëjnë titullarët e atij institucioni, nuk kemi më mundësi që të bëjmë debat mbi këto gjëra.

Shqetësimin tuaj dhe jo vetëm tuajin por i të gjithë KLGJ-së këtu, pa diskutim që ishte pjesë e fjalës time, ishte pjesë jo vetëm e fjalës time në Kuvend por edhe tek Komisioni i Ligjeve, kështu që nuk besoj se ishte koment shumë etik të flisnit.

Tani, për sa i përket pjesës së propozimit...

Alban Toro: Meqenëse ma vure në dyshim etikën, atëherë po vazhdoj, nëse më jep mundësi të flas.

Naureda Llagami: Po, vazhdo!

Nuk po të pengoj të drejtën për të folur.

Alban Toro: Okej! Dakord! Se nuk dëgjohet. Ka shkëputje linja dhe kjo është arsyeja që shpeshherë kemi kërkuar që të jemi në sallë dhe jo “online”. Ndërpritet linja dhe nuk marrim vesh se çfarë bëhet. Gjithsesi po vazhdoj.

Unë rregulloren e brendshme të Parlamentit e njoh, por njoh edhe faktin që dikush nuk jep urdhër “hape Gjykatën e Lartë” apo “mbylle Gjykatën e Lartë” dhe këtij urdhri unë kam mundësi t’i përgjigjem në mënyrë adekuate dhe duke ruajtur seriozitetin e institucionit. Atë gjë unë nuk e pashë. Ky është opinionimi im. Nëse je dakord apo jo, pak rëndësi ka për mua. Por unë shikoj në opinionin tim, shikoj që është cenuar pavarësia e institucionit kur dikush më jep urdhër dhe thotë “hape apo mbylle Gjykatën e Lartë”.

Naureda Llagami: Propozim tjetër kemi?

Fatmira Luli: Unë mendoj që ndoshta do jetë e domosdoshme të bëjmë shpalljen vetëm të... jo të gjithë anëtarëve, vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, por numrin e domosdoshëm për ta bërë funksional, për efekt të zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Ne kemi në dorë që shpalljen ta bëjmë me afate më të gjata, domethënë të tërë vendet bosh, 14 vendet që duhet të jenë, 4 i kemi dhe 10 të tjera që duhet të shpallim, afatet e paraqitjes së kërkesave të jenë jo në kohë të njëjta, të fundit të jenë në një afat më të gjatë, me qëllim që t’i jepet mundësia edhe gjyqtarëve të tjerë që janë në proces vettingu, që e mbarojnë atë, të përfshihen, të kenë të drejtë të marrin pjesë në këtë konkurrim. Kështu që gjykoj që këtë detyrë e kemi për momentin, duhet detyrimisht të

shpallim vende, aq sa duhet, për të bërë funksionale gjykatën, me qëllim që të miratohen gjyqtarët për Gjykatë Kushtetuese. Faleminderit!

Maksim Qoku: Zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Po, Maksi!

Maksim Qoku: Nuk e di nëse nuk do ketë më diskutime.

Atëherë, unë do desha që të hidhej në votë propozimi i Marçelës së pari, për hapjen e 5 vendeve (4 penale dhe 1 administrative).

Brunilda Kadi: Një sekondë, më fal!

Me logjikë duhet të hidhet në votim propozimi im sepse i përfshin të gjithë. Jo se e propozova e para, por sepse ka logjikë që të votohet ky njëherë sepse nëse rrëzohet ky, vazhdohet me të tjerat.

Brikena, unë propozova që të hapen të gjitha në parim, por pa i ndarë në pozicione.

Brikena Ukperaj: Ah okej! Në rregull.

Brunilda Kadi: Sepse bëra edhe atë diskutimin që bëra dhe me logjikë i bie të hidhet ky në votim. Nëse rrëzohet ky, vazhdojmë me të tjerët pastaj.

Ah, një sekondë. I bie që të hidhet në votim propozimi i Albanit që është më i hershëm, që kërkon mendimin e EURALIUS-it. Mendoj që ky duhet të hidhet i pari.

Naureda Llagami: Jemi dakord të hedhim fillimisht propozimin e Albanit dhe më pas fillojmë me propozimet e kolegëve të tjerë. Duke qenë se Albani kërkon që të marrim një mendim të specializuar lidhur me çështjen e hapjes së vendeve, nëse hapja e të gjithë vendeve mund të cenojë funksionalitetin e sistemit. Hidhet në votim.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Atëherë, unë jam pro, me arsyetimin që Misioni e njeh situatën makro pra jo vetëm situatën në pozicionin e Këshillit por edhe të institucioneve të tjera që përfshihen në këtë proces. Për më tepër që edhe kur ne shpallëm herën e kaluar 6 vende, nuk më kujtohet mirë nëse e kanë dhënë me shkrim apo jo opinionin, por ideja e

EURALIUS-it ka qenë që vendet jo vetëm që duhet të hapen jo të gjitha por madje mundësisht edhe një nga një. Kështu që edhe unë do doja të dija mendimin e tyre, duke e parë situatën makro. Sot, mbi gjithçka që ka ndodhur, si e mendojnë ata do ishte më e mira dhe mundësisht, nëse shumica voton 'Pro' të kërkohet që ky mendim të jepet sa më shpejt të jetë e mundur.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Kundër, me idenë që vullneti i përfaqësuesve të misioneve dhe të përfaqësuesve të ambasadave të cilët ato përfaqësojnë, edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe të Komisionit Evropian, janë shprehur qartë që duhet urgjentisht të bëhet sa më shpejt funksionale Gjykata e Lartë, me qëllim që të zgjidhen anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kështu që mendoj që është humbje kohe të marrim mendim, por të procedojmë me zgjedhjen e 10 anëtarëve, për të bërë funksionale Gjykatën e Lartë. Faleminderit!

Marçela Shehu: Dakord. Unë e paraqita një propozim konkret, por gjithsesi duke e konsideruar faktin që ka disa mendime, propozimet janë të ndryshme, dhe gjithë situatën e sistemit, vlerësoj që çdo opinion do të ishte i vlefshëm dhe i rëndësishëm në këtë moment. Jam dakord.

Erjon Muharremaj: Pro. Në vijim edhe të qëndrimeve të mia të mëparshme në lidhje me marrjen e mendimit nga partnerët tanë strategjikë.

Brikena Ukperaj: Dakord, për të gjitha sa u argumentuan nga kolegët.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që përpara se të vlerësojë hapjen e të gjithë vendeve vakante apo jo, të marrë një mendim të specializuar nga Misioni i EURALIUS dhe USAID-i, mbi si duhet të procedojë Këshilli në këtë situatë, nëse cenohet funksionaliteti i gjykatave të tjera me hapjen apo jo të të gjithë vendeve vakante.

Unë do lutesha që të vendosim një afat lidhur me marrjen e këtij opinion, duke qenë se çështja e Gjykatës së Lartë është një çështje shumë prioritare, kërkoj edhe nga ju nëse mundeni të bëni një propozim, për të lënë një afat shumë të shkurtër opinioneve, për

të na dhënë një qëndrim mbi këtë çështje, me qëllim që javës tjetër, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të bëhet një rivlerësim i situatës për hapjen e vendeve vakante.

Sa mendoni që mund t'i lëmë një afat?

Erjon Muharremaj: A mund të them diçka zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Erjon!

Erjon Muharremaj: Personalisht gjykoj që nuk do të ishte e përshtatshme që ne t'u caktojmë afate partnerëve tanë, por ashtu siç e përmendi edhe zonja Kadi në fjalën e saj, duhet të kërkojmë që brenda mundësive, sa më shpejt që ata të kenë mundësi të na japin këtë opinion për shkak të vetë karakterit urgjent të çështjes. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord.

Në goftë se jeni dakord me propozimin e Erjonit...

Maksim Qoku: Zonja Kryetare, tani, ne duhet ta vëmë një afat se është mirë që të enjten tjetër të jetë materiali gati. Ne e kemi një emergjencë. Nuk shkon që të vonohemi për... të na mirëkuptojnë për afatin që vëmë, por është mirë që të respektojnë një afat. Unë insistoj që të vihet një afat.

Naureda Llagami: Atëherë, jeni dakord me propozimin e Maksit që të lëmë një afat me idenë që duke qenë se kjo çështje është prioritare dhe reagimi ndaj misioneve besoj do jetë mirëkuptues, me qëllim që javës tjetër ta kemi prapë në rend dite duke vlerësuar dhe qëndrimin e tyre.

Erjon Muharremaj: Mundem zonja Kryetare?

Naureda Llagami: Po!

Erjon Muharremaj: Pikërisht, nisur nga fakti që partnerët tanë deri tani, gjatë gjithë kohës, jo vetëm që prej momentit të themelimit të Këshillit, por edhe përpara se të krijohesh, në kushtet që unë kam bashkëpunuar me ta që nga momenti që jam zgjedhur nga

Kuvendi, në 8 shkurt të 2018, ata janë plotësisht të ndërgjegjshëm për karakterin urgjent të çështjes dhe nuk më duket as etike dhe as e kemi kompetencën ligjore që t'u vëmë ne afate atyre. Unë jam i sigurt që ata do të na kthejnë përgjigje sa më shpejt që të kenë mundësi. Prandaj edhe bëra propozimin që të mos caktojmë afat. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Edhe unë jam dakord me arsyetimin e Erjonit.

Marçela Shehu: Kryetare, më fal, më duket disa përfaqësues të misionëve po e ndjekin mbledhjen “online” kështu që besoj ata e dinë rëndësinë e situatës por e kuptuan edhe shqetësimin tonë, kështu që besoj me një njoftim sa më shpejt që të jetë e mundur, besoj që e kemi ezauruar edhe këtë pjesën e shpejtësisë së marrjes së informacionit.

Naureda Llagami: Dhe pse jo, t'i bëjmë me dije që Këshilli në javën tjetër do ta fusi prapë në rendin e ditës këtë çështje.

Marçela Shehu: Prandaj e thashë që ata po e ndjekin online, po e ndjekin të gjithë diskutimin, shqetësimin dhe besoj edhe ata vetë janë të interesuar me përgjegjshmërinë e lartë, ashtu sikurse edhe ne, për t'u përgjigjur dhe për të reaguar sa më shpejt.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord që mos t'i vëmë një afat ditor por të themi që mundësisht të na jepet një qëndrim sa më shpejt të jetë e mundur, duke qenë se Këshilli do që javës tjetër ta përfshi prapë në rendin e ditës.

Jemi dakord me këtë qëndrim?

Fatmira Luli: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, çështja në fjalë do të shtyhet deri në pritjen e mendimit nga partnerët tani, ndërkohë, meqë jemi ende tek Gjykata e Lartë, pa shkuar tek pjesa e delegimeve, unë në fakt do doja t'ju informoja që nga partnerët tanë është

menduar që të bëhet një event ndërgjegjësues dhe një event i nivelit të lartë, propozohet si datë data 16 dhe 17 korrik. Në bazë të këtij event i do të jenë të pranishëm të dy ambasadorët, si ambasadori i BE-së ashtu edhe ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Akoma jemi në fazën e konfirmimit të datave. Kuptohet që çështja mjaft e rëndësishme e këtij takimi dhe pse këta dy ambasadorë kërkojnë që të zhvillojnë një event të tillë është Gjykata e Lartë dhe si të bëjmë Gjykatën e Lartë sa më eficiente, duke ulur edhe bekllog-un. Në kuadër të këtij takimi, pa diskutim një nga çështjet që do jetë edhe me sensitivitet të madh është pjesa që pavarësisht se Këshilli ka marrë gjithë ato masa për të ulur bekllog-un dhe për të rritur eficientën Gjykatës së Lartë, ajo që është shumë e rëndësishme është që në ndërmarrjen e këtyre masave duhet një vizion i qartë me “deadline” dhe me afate të caktuara sesi ne do ta realizojmë këtë dhe pse jo të kemi një qasje sa më të hapur ndaj publikut, pra që edhe publiku ta kuptoj se kush janë masat që Këshilli ka ndërmend të marri. Për këtë arsye, marr shkas edhe tek ajo që zoti Bici foli dhe tha lidhur me prioritetin e Gjykatës së Lartë, është menduar që të hartohet së bashku me partnerët tanë një udhërrëfyes për punën që ne po bëjmë, se në fakt kemi bërë shumë punë për Gjykatën e Lartë dhe po vazhdojmë të punojmë intensivisht, një udhërrëfyes i cili do na lejojë ne të jemi më konkret dhe më të matur, jo vetëm për punën tonë por edhe më të prekshëm për publikun dhe kjo do jetë edhe një nga çështjet që ne do i prezantohemi pjesës së partnerëve tanë (ambasadorëve). Kështu, në këtë lloj kuadri, pa dashur që të shkojmë në gjëra konkrete, unë do ftoja që gjithsecili prej nesh, kush e konsideron, sidomos flas edhe për Komisionet, që të jemi pjesë e një hartimi të këtij dokumenti, i cili në fakt është shumë i rëndësishëm sepse është një dokument që do publikohet, është një dokument i cili do jetë më konkret për publikun dhe nga ana tjetër është një dokument që ne do bëjmë të qartë kush është vizioni ynë dhe si janë hapat tonë për pjesën e bërjes eficënce të Gjykatës së Lartë. Kështu që unë do doja që secili nga Komisionet e Përhershme, pse jo edhe nga Komisioni i Përkohshëm që kemi ngritur për bekllog-un në Gjykatën e Lartë, të propozohet një kandidat, një person, qoftë edhe vullnetar, për të punuar mbi këtë dokument. Kështu që unë do ju nis një e-mail dhe do mundësohem që të ngremë një grup pune, të paktën midis nesh, që të punohet, ta rishikojmë këtë dokument, që kur ta prezantojmë në prezencën e të dy ambasadorëve, të jetë një dokument i dakordësuar nga të gjithë bashkë. Dakord?

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Llagami

Specialiste

Rosalba Xhabrahimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.07.2020)

Pika 13 shtesë e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 17:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

¹ Procesverballi i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

13 (shtesë). Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalohet në çështjen e fundit e cila është shtesë në rendin e ditës. Fjala i jepet zotit Toska i cili bën një relativitet të shkurtër të dy kërkesave që kanë ardhur të karakterit tepër urgjent, nevoja për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe një tjetër në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Fillimisht vijohet me relativitetin e relacionit të parë **“Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore për përjashtim të trupit gjykues.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit

kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar informacionit të dërguar nga gjykata në nevojë dhe cakimit më herët nga Këshilli me short të një gjyqtari për shqyrtimin e një kërkesë për përjashtim trupi gjykues në të njëjtën çështje gjyqësore, Komisioni ka këtë propozim që: Për 1 çështje, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur me short të konsiderohet gjyqtarja Margarita Buhali, e cila është caktuar më herët nga Këshilli për gjykimin e të njëjtës lloj kërkesë për përjashtim gjyqtari në të njëjtën çështje dhe është gjyqtare e cila bën pjesë në rrethin e gjyqtarëve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më sipër.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimet e Këshillit.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “**Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër**”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, Gjkata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Në fakt, për këtë çështje, edhe më herët Gjkata e Apelit Shkodër ka paraqitur kërkesë për caktim gjyqtari duke marrë shkas nga mosparaqitja në detyrë prej disa javësh të gjyqtarit Aleks Nikolli, i cili në vijimësi ka paraqitur raporte për paaftësi të përkohshme në punë dhe nuk është paraqitur në detyrë, gjë të cilën e ka bërë edhe ditën e djeshme, shkak për të cilën është shtyrë sërish seanca gjyqësore në atë rast. Ndërkohë, sipas kërkesës së dërguar nga gjykata, afati i paraburgimit të pandehurit përfundon në datën 16 korrik 2020, duke mos përfshirë këtu dy seancat e shtyra për të cilat janë pezulluar afatet e paraburgimit.

Nga ana tjetër, ka pasur edhe një komunikim të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër me zotin Aleks Nikolli dhe në njoftimin e bërë sot nga zëvendëskryetari ka konsideruar se pas përgjigjes së marrë nga zoti Aleks lidhur me vijimin e mosparaqitjes në detyrë ka konsideruar si një dorëheqje dhe ai e ka miratuar atë. Marrë shkas nga kjo vijohet me shqyrtimin e kësaj kërkesë ku Këshilli do duhet të zbatojë vendimin e tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një

çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet me short gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, si vijon: znj. Shpresa Beçaj, për të cilën procesi i rivlerësimit kalimtar është në fazën e shpalljes së vendimit; z. Alaudin Malaj, i cili është caktuar në shortin e mëparshëm (të datës 18.06.2020) për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 13 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor